



**KONCEPTI PËR  
PËRPILIMIN E LIBRIT**

**METODOLOGJIA PËR  
VLERËSIMIN E LIBRIT**





# KONCEPTI PËR PËRPILIMIN E LIBRIT DHE METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E LIBRIT

SHKUP, dhjetor 2010

**Botues:** Byroja e zhvillimit të arsimit  
Për botuesin, Mr. Vesna Horvatoviq, drejtor

### **Ekipi profesionist**

Byroja e zhvillimit të arsimit:

Mr. Mitko Çeshllarov, Mr. Vesna Horvatoviq, Mr. Igor Jurukov, Liljana Samarxhiska – Panova, Ajshe Ajrullai, Sillvana Veteroska, Zllata Markovska, Svetllana Brashnarska, Gordana Doneva – Atanasoska, Ivanka Mijiq, Abdurrahman Memeti, Janaçko Shterjov, Mr. Ankica Vitanova, Trajko Jovanovski, Gordana Janakievska, Julija Gligorova – Trajanovska, Mirjançe Milloshevska, Nikollçe Ilijevski, Bllaga Paneva, Nada Nikollova, Goce Shopkoski, Liljana Polenakoviq, Trajçe Gjorgjijevski, Ivica Gievski, Ognjena Maleska - Drakallska, Marija Simonova, Mito Stefanovski

### **Qendra për arsim të mesëm profesional dhe trajnim:**

Dr. Laste Spasovski  
Mr. Roza Arsovska  
Branko Aleksovski  
Zoran Jovçevski  
Lidushka Vasilevska  
Çedomir Dimovski

**Recenzentë:** Prof. Dr. Snezhana Adamçevska

### **Konsultantë për kriteret për multikulturalizëm:**

Prof. Dr. Violeta Petreska Beshka, Safet Ballazhi

### **Përkthim dhe lekturë:** C. E. S. -

центар за образовни услуги

**Shtypi:** M-M Marija doel

### **Tirazhi:**

1000 në gjuhën maqedonishte

500 në gjuhën shqipe



Botimi është publikuar me përkrahjen financiare dhe profesionale nga Zyra e UNICEF –it, Shkup si pjesë e programit të Kombeve të Bashkuara për përforcimin dhe bashkëpunimin e dialogut ndëretnik, të financuar nga Qeveria Spanjolle përmes qëllimeve zhvillimore mijëvjeçare.



CIP – Katalogjizimi në publikim

Biblioteka Universitare nacionale „Shën Klimenti i Ohrid” Shkup

373.3/.5.091.64

Koncepti për përpilimin e librit dhe metodologjia për vlerësimin e librit /- (Byroja e zhvillimit të arsimit), Shkup: Byroja e zhvillimit të arsimit, 2010.-112 fq.:21 cm

Bibliografia: faqe 98-100

ISBN 978-608-206-034-7

- Tekste shkollore për arsimin fillor – Koncepti dhe vlerësimi
- Tekste shkollore për arsimin e mesëm – Koncepti dhe vlerësimi

COBISS. MK – ID 86130698



PËRMBATJA

---

<b>6</b>	<b>PARATHËNIE</b>
<b>10</b>	<b>HYRJE</b>
<b>12</b>	<b>KONCEPTI PËR PËRPILIMIN E LIBRIT</b>
<b>14</b>	<b>I. KRITERET THEMELORE PËR PËRPILIMIN E LIBRIT</b>
<b>24</b>	<b>II. KRITERET PËR PËRGATITJEN E LIBRAVE NË DISA LËNDË TË VEÇANTA NË ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM</b>
25	LIBRA PËR LËNDË MËSIMORE NË MËSIMIN KLASOR (KLASA E I-V)
30	KRITERE PËR PËRPILIMIN E LIBRIT TË GJUHËS MAQEDONISHTE, GJUHËS SHQIPE, GJUHËS TURKE, DHE GJUHËS SERBE NË ARSIMIN FILLOR, RESPEKTIVISHT NË GJUHË DHE LETËRSI MAQEDONISHTE, GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE, GJUHË DHE LETËRSI TURKE NË ARSIMIN E MESËM
34	GJUHA MAQEDONISHTE PËR BASHKËSITË/GJUHA DHE LETËRSIA MAQEDONISHTE PËR BASHKËSITË
38	MATEMATIKA
42	HISTORIA
46	GJUHA E HUAJ
50	BIOLOGJIA
54	KIMIA
58	GJEOGRAFIA
62	INFORMATIKA
66	FIZIKË
70	ARSIMI MUZIKOR
76	ARSIMI FIGURATIV
80	GJUHËT KLASIKE (GJUHA LATINE /GJUHA E VJETËR GREKE)
84	PSIKOLOGJIA
88	LIBRAT NË LËNDËT PROFESIONALE NË ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL
<b>94</b>	<b>III. STANDARDET TEKNIKE TË LIBRIT</b>
98	BIBLIOGRAFIA
<b>102</b>	<b>METODOLOGJIA PËR VLERSIMIN E LIBRIT</b>

PARATHËNIE

---



Dorëshkrimi me titull: KONCEPTI PËR PËRPILIMIN E LIBRIT DHE METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E LIBRIT i ofruar nga grup autorësh nga Byroja e zhvillimit të arsimit paraqet studim serioz instruktiv-metodologjik dedikuar dy strukturave të përgjithshme shfrytëzuese: autorëve të teksteve shkollore dhe ekipeve profesioniste për vlerësimin e teksteve shkollore të përpiluara sipas zgjidhjeve të ofruara konceptuese.

Sipas strukturës së saj, elaborat të hollësishëm të të gjitha komponentëve relevante të teksteve shkollore në arsimin e detyrueshëm në Republikën e Maqedonisë, dorëshkrimi përmban vërejtje metodike- didaktike të doracakut i cilin mund ta shfrytëzojë edhe opinionin më i gjerë profesional: studentët e fakulteteve të cilët edukohen për mësimdhënës të ardhshëm për arsimin e detyrueshëm, mësimdhënësit e mësimin praktik, shërbimet profesionale në shkolla, aktivët e mësimdhënësve të lëmive të ngjashme dhe programeve të afërta dhe shkalla e arsimimit, organet, trupat dhe individët e ekipeve për evalvim si dhe prindërit e nxënësve në arsimin e detyrueshëm fillor dhe të mesëm. Në tërësi, dorëshkrimi është komponuar prej dy pjesëve të cilat kanë të bëjnë në dy funksione të qarta dhe po të njëjtat do ti ketë në opinionin tonë profesional: ofertë të zgjidhjeve konceptuale për përpilimin e tekstit dhe dimensione metodologjike për vlerësimin e tekstit shkollor. Dorëshkrimi përmban 110 faqe të formësuar në kompjuter, me pjesën hyrëse dhe set të ofruar të

instrumenteve struktura ajtme e të cilave kahëzon drejt evalvimit objektiv të tekstit shkollor të ofruar mundësisht me vlerësime konkrete, relevante dhe elemente suptile.

Dëshmojmë në faktin se në dorëshkrim janë respektuar kërkesat bartëse të parimeve didaktike për tejkalimin e njëllojshmërisë dhe njëfarësisë në kriteret për përpilimin dhe vlerësimin e çfarë do lloji të librit. Në dorëshkrim janë ofruar zgjidhje dhe kriteret të cilat në mënyrë suptile i respektojnë indikatorët bartës pedagogjik, psikologjik dhe kulturologjik të cilësisë së librit dedikuar moshës përkatëse apo strukturës së nxënësve, të kushtëzuar nga specifika e lëndës mësimore për të cilën duhet ose është përpiluar libri apo teksti shkollor, pikëpamja e qëllimeve të lëndës mësimore, specifika e kor-kurikulimit të lëndës përkatëse mësimore dhe në veçanti korrespondencës pedagogjike, qëllimit, përmbajtjes dhe asaj konceptuale të librit dhe programit të dizajnuar mësimor në lëndën përkatëse mësimore.

Pjesa e parë e dorëshkrimit i elaboron aspektet e zgjidhjeve konceptuale për përpilimin e librit. Duke definuar librin si mjet dominues dhe burim për zhvillimin e nxënësit në të gjitha sferat dhe lëmit: kognitive, afektive dhe psikomotorike. Në kahet e përgjithshme në atë pjesë autorët tregojnë se libri mund të jetë burim bartës, por edhe një ndër elementet e të ashtuquajturës pako didaktike në të cilin përpilohen: fletorja e punës, praktika, ushtrime, si dhe doracaku

metodik për mësimdhënësin, si dhe mjete të teknologjisë bashkëkohore arsimore (kaseta, disketa, monografi, fjali etj.).

Në këtë pjesë me analitikë të saktë janë prezantuar kriteret elementare për përpilimin e librit.

- përputhja e përmbajtjeve të librit me programin mësimor;
- përqendrimi në të arriturat bashkëkohore nga lëmi shkencor i caktuar dhe përdorimi i terminologjisë profesionale;
- elemente të shtojcave vizuale dhe komponenta grafike-ilustruese të cilat libri duhet ti ketë si elemente të aparaturës metodike-didaktike të librit;
- përputhja e librit me moshën e nxënësve;
- të shprehurit e funksionit edukativ, raport pozitiv ndaj shkencës/diturisë, zhvillimi i identitetit qytetar dhe nacional, multikultura dhe barazia gjinore.

Përveç kriterëve të përgjithshme për përpilimin e librit në dorëshkrim janë prezantuar edhe kriteret specifike të cilat kanë të bëjnë me lëndët e ndryshme mësimore të cilat bëjnë pjesë në lëmit e ndryshme programore në arsimin fillor dhe të mesëm të detyrueshëm (libra për lëndët mësimore në mësimin klasor (klasa e parë-e pestë), libra për mësimin lëndor në arsimin fillor dhe në gjimnaz dhe libra për arsimin e mesëm profesional me indikatorë qartë të identifikuar për cilësi dhe tërësi e përmbajtje

evidente dhe dimensione procesore-paraqitëse në proceset e mëimit dhe mësimnxënies të cilat librat duhet ti përmbajnë në pajtim me kriteret e përgjithshme dhe specifikat e lëndës mësimore.

Autorët vëmendje të posaçme i kanë përkushtuar dimensioneve mikrometodike të aspekteve prezantimeve-operative të mëimit të cilat libri duhet ti iniciojë, kurse mësimdhënësi ti ndjek dhe udhëzojë në kuadër të proceseve të mësimdhënies dhe ti shohë gjatë proceseve të mësimnxënies (terminologjia e përputhur, zgjerimi i fjalorit aktiv të nxënësve, mungesa e thjeshtësimit të fakteve dhe relacioneve ndërmjet nocioneve, thjeshtësia dhe zotërimi terminologjik, integrimi i qëllimeve dhe aktiviteteve, kuptimi i fakteve, korrelacioni i përmbajtjeve, rezymeja tematike dhe përshkrimet e domosdoshme dhe strukturimi i përmbajtjeve, etapa paralajmëruese artikulative të orës dedikuar për relacionin e qëllimeve nga tema përkatëse ose lënda mësimore etj.

Në veçanti i theksojmë aspektet e kriterëve të cilat duhet të respektohen gjatë përpilimit të librave dedikuar për klasat fillestare të arsimit fillor, kurse kanë të bëjnë me jo më pakë për elementet më të rëndësishme në proceset e arritjes të shkrimleximit fillor elementar:

- madhësia e shkronjave;
- dendësia e tekstit;
- gjatësia e fjalëve;
- funksioni i komponentëve ilustruese si iniciativë njohëse ose përkrahje e tekstit;
- raporti tekst-ilustrim.

Në pjesën e dytë të përgjithshme të dorëshkrimit autorët kanë ofruar metodologji të rëndomtë dhe shumë suptile për vlerësimin e librave. Është ofruar set prej disa instrumenteve të cilat kanë të bëjnë me katër kriteret bartëse për vlerësim (përputhja e përmbajtjeve të librit me programin mësimor, përmbajtje në të arriturat bashkëkohore nga lëmi i caktuar shkencor dhe përdorimi i terminologjisë profesionale, përputhja e librit me moshën e nxënësve, funksioni edukativ, zhvillimi i identitetit qytetar dhe nacional, multikultura dhe barazia gjinore) me indikatorë qartë të definuar për vlerësim me tre shkallë të përfshirjes/pranisë në librin konkret.

Metodologjia për vlerësimin e librit është kombinimi i teknikave cilësore dhe sasiore që kontribuon secili qëndrim i ndërmarrë të jetë i argumentuar me argument analitik i cili pikësohet në mbarim të kontrollimit sumativ/përmbledhës të indikatorëve.

Prof. Dr. Snezhana Adamçeska

HYRJE

---

Në pajtim me Ligjin e Byrosë për zhvillimin e arsimit, si dhe ligjin për libra të arsimit fillor dhe të mesëm, Byroja për zhvillimin e arsimit është kompetente për përpilimin e librit dhe metodologjisë për vlerësimin e librit.

Në këtë drejtim, këshilltarët e Byrosë për zhvillimin e arsimit, në bazë të përvojës së deritanishme dhe dokumenteve ekzistuese (Koncepti i librit për arsimin fillor dhe të mesëm<sup>1</sup>).

Metodologjia për vlerësimin e librit për dhe arsimit i mesëm<sup>2</sup>), kanë përgatitur kritere të përgjithshme të cilat duhet ti plotësojnë librat për arsimin fillor dhe të mesëm, dhe kanë të bëjnë para së gjithash me harmonizimin e librave me programet mësimore, përmbajtjes deri te të arriturat bashkëkohore nga lëmia e përcaktuar shkencore dhe përdorimi i terminologjisë profesionale, përputhshmëria e librave me moshën e nxënësve dhe funksionit edukues të librit.

Kriteret e theksuara kanë të bëjnë me përmbajtjet e librave, shtojcave vizuale, stilit dhe gjuhës, teksteve plotësuese, pyetjet dhe detyrat dhe të gjitha elementet tjera të cilat duhet ti përmbajë çdo libër bashkëkohor.

Në bazë të kriterëve të përgjithshme, janë zhvilluar kritere të veçanta për disa lëndë mësimore për lëndë të

arsimit të përgjithshëm në arsimin fillor dhe të mesëm, ndërsa janë vendosur edhe kritere për librat për lëndët shkencore në arsimin e mesëm profesional të përgatitura nga Qendra për arsim të mesëm profesional dhe trajnim.

Në kuadër të dokumentit si pjesë e ndarë është vendosur Metodologjia për vlerësimin e librave ku në bazë të kriterëve të vendosura janë realizuar indikatorë të cilët duhet ti udhëheqin komisionet recensuese gjatë vlerësimit të dorëshkrimeve për librat. Përveç pikësimit apo pikësimit sipas indikatorëve të theksuar (të shkallës prej 1 deri në 3), komisionet recensuese janë të obliguar të japin edhe pikëpamjen e tyre dhe vlerësim të dorëshkrimit për libër (në mënyrë narrative) dhe në bazë të pikave për secilin aspekt të theksuar, të japin numrin e përgjithshëm të pikave.

Byroja e zhvillimit të arsimit ka pasur për qëllim të përgatisë sa është e mundur dokumente më të rëndomta dhe më të qarta- Koncepti për përpilimin e librit dhe Metodologjia për vlerësimin e librit, të cilat do të zbatohen dhe autorëve do tu ndihmojnë në shkruarjen e librave cilësorë, ndërsa komisioneve recensuese në sigurimin e vlerësimit objektiv, profesional dhe cilësor të dorëshkrimeve për libra.

1 Koncepti për libër për arsim fillor dhe të mesëm (2006) , Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup.

2 Stojanovski,T. dhe Timovski, V. (2005). Metodologjia për vlerësimin e librave për arsim fillor dhe të mesëm, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup.

# KONCEPTI PËR PËRPILIMIN E LIBRIT

---

Libri ka marrë vend të rëndësishëm në procesin edukativo-mësimor dhe paraqet mjet themelor dhe integral për nxënien e njohurive dhe për njohjen më të lehtë të nocioneve dhe informatave. Roli i tij kryesorë është që në mënyrë didaktike ti klasifikojë përmbajtjet mësimore dhe shkencore, në pajtim me kërkesat pedagogjike dhe funksionin edukativo- arsimor të shkollës.

Në këtë drejtim nënkuptojmë se libri është burim i njohurive dhe mjet mësimor i cili përdoret për arritjen e qëllimeve edukativo-arsimore në mësim dhe të mësuarit. Libri i mundëson nxënësit ti arrijë standardet e njohurive dhe ta nxisë zhvillimin e aftësive: **në lëmin kognitiv** ( nga të kuptuarit, zbatimin e njohurisë, analizës, sintezës deri te vlerësimi ), **në lëmin afektiv** ( nga zhvillimi i aftësive për pranimin dhe marrjen e vlerësimeve deri te formimi i qëndrimeve ) dhe në **lëmin psikomotorik** ( nga nxitja e librit me aktivitete të paramenduara deri te përfitimi i shkathtësive manipuluese dhe vlerësimi individual i punës praktike ).

Varësisht nga natyra e lëndës mësimore mund të ofrohet vetëm libër ose, komplet didaktik, i përbërë prej më shumë pjesëve (libër, fletore pune, praktikum, respektivisht ushtrime ose mjete tjera mësimore ), në pajtim me natyrën e procesit mësimor dhe të mësuarit.

Në praktikën bashkëkohore përveç librit rekomandohet që të jepet edhe doracak metodologjik për mësimdhënësin.

Libri duhet të ketë karakter multimedial, i bazuar në ndryshimet më të reja informatike dhe teknologjike në botë, të cilat paraqesin faktorin plotësues për formësimin më të

plotë, më interesant dhe më bashkëkohor të përmbajtjes, si dhe për plotësimin e aftësive të nxënësve (kahe digjitale të informatave, monografive, fjalive etj). Libri duhet të jetë i strukturuar në pajtim me konceptin multidisiplinar të mësimin dhe kushteve reale në të cilat realizohen programet mësimore.

Koncepti për librin i definon kushtet e përgjithshme për përpilimin e librit për arsim fillor dhe të mesëm ku çdo nxënës duhet:

- ▶ të jetë në lidhje të ngushtë me qëllimet e definuara të programit mësimor për lëndë të caktuara mësimore dhe ti plotësojë qëllimet konkrete dhe ato të përgjithshme të çdo tërësie tematike;
- ▶ ti përcjellë të arriturat bashkëkohore nga lëmia e caktuar shkencore dhe terminologjisë së pranueshme (përkatese) shkencore dhe të jetë sintezë e më shumë elementeve pedagogjike, psikologjike, metodike dhe didaktike, raporti reciprok i të cilave është korrelativ, komplementar dhe dinamik;
- ▶ të shprehet në moshën e nxënësve (ti përcjell karakteristikat zhvillimore të nxënësve , ndërsa stili dhe gjuha të jenë të qarta dhe të kuptueshme);
- ▶ Ta përforcojë komponentën edukuese, raportin pozitiv ndaj diturisë, zhvillimin e identitetit qytetar dhe nacional, kulturat e shumta, barabarësinë gjinore etj.

# **I. KRITERET THEMELORE PËR PËRPILIMIN E LIBRIT**





## Përputhshmëria e përmbajtjes së librit me programin mësimor

Gjatë përpilimit të librit, respektivisht gjatë vlerësimit të tij duhet të mbahet llogari për përputhshmërinë e tij me programin mësimor të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, me propozim të Byrosë së zhvillimit të arsimit.

Kjo nënkupton që përmes zhvillimit të disa përmbajtjeve në libër të arrihen qëllimet e definuara me programin. Më pas duhet të kihet parasysh qëllimet për klasën, respektivisht vitin, llojin e arsimit, si dhe drejtimin, respektivisht profili arsimor i arsimit për të cilin është dedikuar libri, si dhe qëllimet konkrete që duhet të arrihen gjatë realizimit të programit mësimor.

Në bazë të qëllimeve të parashtruara në programin mësimor, në libër duhet të parashihen përmbajtje (nga ana e autorit) në pajtim me fondin e orëve mësimore të programit, temat (lëmit) të cilat përpilohen dhe nocionet që zbatohen në programin mësimor.

Gjatë zgjedhjes së përmbajtjeve duhet të përfshihen parimet racionale dhe ekonomike, që nënkuptojnë zgjedhjen e përmbajtjeve përkatëse (sipas vëllimit, stilit dhe gjuhës) të moshës së nxënësve të cilëve iu është dedikuar libri. Libri kryekëput duhet ti përmbahet programit mësimor dhe ti respektojë dhe zbatojë udhëzimet didaktike të programit për qasje graduale dhe

sistematike të nxënësit në materie të lëndës.

Gjithashtu, në pajtim me programin mësimor, libri duhet ti përmbahet dhe të promovojë metoda interaktive të punës, korrelacion me lëndë tjera (të ngjashëm) mësimore. Lidhshmëri horizontale dhe vertikale të përmbajtjeve në kuadër të lëndës, si dhe të përmend edhe shembuj tjerë dhe burime të informatave dhe njohurive për temat (lëmit) të përfshira me programin (enciklopeditë, fjalitë, përmbajtjet elektronike, softuer arsimor etj.)

- Përmbajtja ndaj të arriturave bashkëkohore të lëmit të caktuar shkencor, metodologjia e studimit të lëndës dhe përdorimi i terminologjisë profesionale

### *Struktura e përmbajtjeve në libër*

Çdo libër duhet të jetë autentik dhe vepër origjinale e autorit, të ketë kompozim të qartë i cili nxënësit i mundëson që lehtë dhe pa ngarkesë të gjendet në te dhe ta përdorë në mësim dhe mësimnxënie. Libri, në përgjithësi duhet të jetë i strukturuar në këtë mënyrë: të ketë hyrje (i përcjella me parathënie të qartë/udhëzim për përdorim të librit), përmbajtje, kapitull (sipas temave, respektivisht komponentëve të programit mësimor), përmbajtjeve (të zhvilluara nga autori në pajtim me qëllimet në program) të cilat do të përfshijnë pjesë autentike narrative, shembuj, konkluzione, pyetje dhe detyra dhe do të dëftonin burime plotësuese për nocionet,

respektivisht termet profesionale që përpilohen, si dhe për thellimin e njohurive (përmbajtjeve elektronike, ueb faqeve, teksteve, fotografive, vizatimeve dhe tabelave, grafikoneve, skemave, regjistrave, vërejtjeve etj. Libri është i preferuar të përmbajë regjistër të nocioneve, sqarime për fjalitë e panjohura etj.

## Bazueshmëria shkencore e përmbajtjeve

Gjatë përpilimit të librit (veçanërisht gjatë vlerësimit të tij) më me rëndësi është që autori në secilin libër ti përmbahet të arriturave bashkëkohore nga lëmi i caktuar shkencor dhe të përdor terminologji përkatëse shkencore. Secila përmbajtje në libër duhet bazuar në bazë të shkencës dhe të ofrojë informata dhe njohuri të konfirmuara.

Libri duhet të paraqesë sintezë të elementeve pedagogjike, psikologjike, metodike dhe didaktike, respektivisht të bazohet në metodologjinë, të vijojë qasje të qartë, të saktë dhe të sistemuar në përcjelljen e informatave dhe njohurive përshtatur moshës, aftësive dhe interesave të nxënësve.

Nëse autori përdor/ merr/citon literaturë shkencore dhe profesionale dhe ilustrime, është i obliguar ta përmendë burimin e literaturës së përdorur. Përfitimi i njohurive dhe zhvillimi i aftësive të nxënësve ka të bëjë me të

gjitha nivelet e të menduarit dhe njohurive duke filluar nga **të mbajturit mend** dhe **riprodhimit** (përdorimi i fjalëve të reja, termeve të përdorura në përmbajtje, fakte, mënyra dhe metoda, nocione, rregulla, parimeve themelore, teorive, ligjshmërive etj., **të kuptuarit dhe kuptimi** (sqarimi i njohurive të fjalëve të reja, fakteve, nocioneve, rregullave, parimeve, interpretimit gjuhësor të përmbajtjeve, shprehjeve me kuptim bartëse, sqarimi i skemave, ilustrimeve, vizatimeve dhe shtojcave tjera grafike, sqarimi i njohurive të nocioneve, rregullave me fjalë përkatëse, shprehjeve, shenjave matematikore), **zbatimi i njohurive** (sistematizimi i detyrave, ushtrime dhe aktivitete në nivele të ndryshme të ndërlikueshmërisë, përdorimi i udhëzimeve të caktuara, formulave matematikore, zbatimi i rregullave, ligjeve, teorive në situata konkrete ose në konstruksionin e ri të detyrave nga elemente të reja dhe të njohura, demonstrimi se si përdoren metodat, procedurat, demonstrimi i përpjekjeve, ushtrime dhe **nxitja e aktiviteteve të menduara më të ndërlikuara – analizë, sintezë dhe vlerësim** (zbërthimi/analizimi i një dukurie, teksti, detyre etj., në tërësinë logjike dhe pjesë, analizimi i tekstit me përmbajtje letrare ose shkencore që të shihet struktura e tij, përpilimi i kontrollit të pjesëve të një teksti, lënde, dukurie, procesi dhe zbulimi i lidhshmërisë përkatëse midis tyre, planifikimi i përmbajtjeve, radhitja dhe kombinimi i elementeve në tërësi të re, dallimi i fakteve dhe supozimeve, hulumtimi i raporteve reciproke

dhe ndikimet e ndërsjella të faktorëve të ndryshëm në dukurinë ose procese të ndara, zbulimi i titujve (idesë, porosisë etj) në organizimin e tekstit, krijimi i skemave dhe strukturave të reja, përbërja e planit për prezantim ose të shkruarit e referatit etj., zbulimi dhe hulumtimi i supozimeve të fshehta, mësimi i gabimeve dhe lëshimeve në gjykimin logjik në tekstin e prezantuar ose lloj tjetër i prezantimit (me simbole, shenja etj), zbulimi i dallimeve midis arsyeve dhe pasojave, vlerësimi i rëndësisë së të dhënave, të shkruarit e përbërjeve krijuese, përpilimi i planit për eksperiment, hulumtim dhe aktivitet tjetër, përdorimi i njohurive nga lëmi të ndryshme për realizimin e planit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, gjykimi për arsyetimin ose bazës shkencore të një pohimi, zgjedhja dhe zbatimi i metodave përkatëse dhe veprimet në procesin e njohur, vlerësimi i ndryshimeve shoqërore si dhe dukurive.

Përmbajtjet e zgjedhura duhet të jenë të kuptueshme për nxënësit. Të ekspozohen me radhitje logjike të gjendjeve, aksioneve, ndodhive të cilat përpunohen.

Përmbajtjet në libër duhet të përfshijnë tekste profesionale dhe informative të cilat mundësojnë sistematizim, integrim, zbatimin e njohurive dhe shkathtësive përkatëse, si dhe zhvillimi i interesit për aktivitet të njohur dhe hulumtues te nxënësit.

### *Tekste plotësuese, pyetje dhe detyra*

Përmbajtjet në libër duhet të parashohin forma të ndryshme të aktiviteteve për përvetësimin e lëndës, metodave për njohuri, detyra, pyetje, përpjekje, eksperimente, operacione logjike, konfirmimi dhe përgjithësimi i lëndës mësimore.

Është e nevojshme të bëhet radhitje e menduar mirë e teksteve të cilat jepen në shtojcë, pastaj fragmentet nga literatura shkencore dhe artistike, të dhënat biografike, treguesit statistikor, tabelat, hartat, diagramet etj.

Libri mund të përmbajë edhe tekste për të sqaruar në lloj të interpretimit, fjalor, regjistër, tabelë, legjenda etj. Në këtë mënyrë mundësohet hyrje metodike e nxënësit në punën mësimore (nga përpunimi i tekstit përmes aktiviteteve të menduara dhe reproduktive deri te kontrollimi i njohurive), si dhe dhënia e elementeve të nevojshme shtuese (pyetje dhe detyra dhe udhëzime për zgjidhjen e tyre, përkujtues, shtojca grafike-ilustruese, vizatime, grafikone, fotografi etj.).

Pyetjet, detyrat, ushtrimet dhe shtojcat tjera duhet ta nxisin nxënësin/nxënësen të kalojë nga aktivitetet më të thjeshta në ato më të ndërlikuara. Me këto nxënësi duhet të udhëzohet si të mësojë dhe të fitojë njohuri, ta zbulojë esencën e nocioneve, ligjshmërive etj. Ata duhet të jenë të koncipuar kështu që do ti ndihmojnë nxënësit/nxënëses në **aplikimin e përmbajtjes së re** (instruksione me të cilat ai/ajo nxitet dhe pavarësisht fillon të vëzhgojë

dhe të mendojë, nxënësin/nxënësen ta përkujtojë në disa karakteristika për shkak të lidhshmërisë me përmbajtjet nga tema e re, ta kontrollojë njohurinë e lëndëve dhe lëmive të afërta të cilat janë të ndërlidhura me përmbajtjet nga tema e re, të ndahen nocionet kryesore, ligjshmëritë, formulat dhe njohuritë tjera që janë bazë kalimtare për përpunimin e përmbajtjeve të reja etj.) ose, gjithashtu, tekstet plotësuese, pyetjet dhe detyrat dedikohen për **përpilim, përsëritje dhe korrigjim të njohurive** (inicimi i aktiviteteve për sistemim, analizë, sintezë, krijimi i bazës për përdorimin e metodave për zbulimin dhe lidhshmërinë e njohurive, krijimi i mundësive që nxënësi të shprehë mendimin e vet, stimulim për thellimin dhe zbatimin e njohurisë, mundësinë për vetëvlerësim të nxënësit me pyetje, hulumtim, detyra, ushtrime etj., të cilat do ti shërbejnë si model se si të mësojë dhe si të përpilojë pyetje për përsëritjen e përmbajtjeve).

Gjatë koncipimit të pyetjeve dhe detyrave bëhet përshtatja e përmbajtjes me nivelin e njohurive, shkathtësive dhe aftësive të nxënësve, prezantimi i përmbajtjeve programore dedikuar, para së gjithash për numër të madh nxënësish por edhe në mënyrë suptile të aplikohen detyra për nxënësit e talentuar.

### *Shtojca vizuale*

Për plotësimin e dhe edukative të librit, si dhe për përkrahjen dhe sqarimin e plotë ose paraqitjen vizuale të disa pjesëve nga përmbajtjet (ose përmbajtje të plota) e domosdoshme është që libri të përmbajë shtojca përkatëse vizuale. Varësisht nga natyra e lëndës mësimore për të cilin dedikohet, në libër mund të vendosen shtojcat vizuale në vijim:

- ▶ ilustrime, riprodhime të veprave artistike;
- ▶ vizatime fëmijësh;
- ▶ ilustrime të disiplinave dhe lëmive të ndryshme shkencore;
- ▶ harta: harta gjeografike, harta historike;
- ▶ skema: skemë organizative; skemë tabelore; trung skemë;
- ▶ diagrame;
- ▶ grafikone: linear, rrethor, ilustrues;
- ▶ stripe;
- ▶ fotografia;
- ▶ ilustrime të shkoqitura nga teksti etj.

Zgjedhja dhe formësimi i shtojcave vizuale çdo herë duhet të jenë në funksion të përmbajtjes ndaj të cilës janë bashkëngjitur dhe sipas shprehjes të jenë përkatëse me moshën e nxënësve për të cilët dedikohet libri.

Shtojcat vizuale çdo herë duhet „ta përjetojnë” tekstin dhe ta nxisin dhe rrisin motivimin, të jenë të lidhura ngushtë me qëllimet nga programi mësimor dhe të mos përdoren „sipas çdo llogarie” edhe jashtë kontekstit.

Teksti çdo herë duhet të jetë burim kryesor i diturisë për nxënësit të cilët dinë të lexojnë (të mos ngecet zhvillimi i mendimit logjik), kurse në librat për klasat fillestare ilustrimet mund ta kenë rolin primar, dhe mandej në librat për klasat dhe vitet më të larta numri i tyre të bie.

Kështu që, varësisht nga lënda mësimore, si dhe nga klasa, përkatësisht viti i mësimit të lëndës, në një libër mund:

- ▶ të ketë shtojca vizuale për pasqyrën e të dhënave dhe ekspozimit të qartë të tyre, dukuri konkrete, nocione ose forma që duhet njihen etj;
- ▶ të ketë ilustrime për mbajtjen e informatave të caktuara gjatë të menduarit;
- ▶ të ndahen etapa të caktuara të proceseve ideore; ose të bëhet sqarim i plotë i ndonjë procesi, mesatarja, të nxitet të menduarit për kushtëzim të ndërsjellë të shkaqeve dhe pasojave në disa dukuri ose procese etj.;
- ▶ të ketë grafikone, tabela, skema dhe shtojca tjera me të cilat sqarohen veprimet dhe mënyra për zgjidhjen e problemit të caktuar etj.;
- ▶ të ketë material autentik historik (harta, skema, ilustrime) sipas përmbajtjes së tekstit, ngjarjeve, personazheve etj.

Gjatë zgjedhjes së shtojcave vizuale duhet pasur kujdes edhe në funksionin e tyre edukativ. Ata duhet të zgjojnë interes dhe mendim tek nxënësit për aktivitete adekuate (të përpunuara me programin) dhe të promovojnë barazi qytetare, fetare, etnike, racore, dhe gjinore.

## **Përputhja e librit me moshën e nxënësit**

Secili libër duhet ti ndjekë karakteristikat zhvilluese të nxënësve, të jetë i kuptueshëm në karakteristikat intelektuale, emocionale, sociale dhe karakteristikat tjera individuale të nxënësve karakteristike me moshën që e mësojnë lëndën mësimore.

Përputhshmëria e librit me moshën e nxënësve reflektohet gjatë racionale dhe ekonomisë gjatë zgjedhjes dhe përpilimit të përmbajtjeve, zgjedhjes dhe përfshirjes së ilustrimeve, mënyrës së parashtrimit të pyetjeve dhe detyrave, si dhe stilit dhe gjuhës në të cilën është shkruar libri.

Në libër duhet të përdoren nocione dhe terme të standardizuara, të sigurohet përshtatja e shprehjeve gjuhësore, të përdoret stili adekuat i zhvillimeve karakteristike të nxënësve, të kultivohet stili i njohur, jo i dykuptimtë dhe bindës, të ofrohet shkallë përkatëse i informimit dhe zbatimi i komunikimit gjuhësor kulturor dhe të zgjohet kureshtja.

Stili dhe gjuha në secilin libër doemos të jenë të qarta dhe të kuptueshme me ç'rast libri duhet të përmbushë standardet e caktuara si:

- ▶ të jetë i shkruar në gjuhën letrare standarde në pajtim me drejtshkrimin e lejuar (shmangie nga gjuha letrare ka vetëm kur jepen tekste autentike të folmes popullore ose forma tjera të shprehjes krijuese);
- ▶ të përdoren terme përkatëse dhe të respektohet terminologjia shkencore e përvetësuar;
- ▶ të ketë sqarime për fjalët e panjohura (fjalë/terme që aplikohen për herë të parë);
- ▶ sqarime për fjalët e pa njohura dhe fjalët e reja të përcjella menjëherë, në vetë tekstin (në veçanti në librat për nxënësit në klasat e ulëta);
- ▶ për sqarim të fjalëve të panjohura të ketë fjalor të posaçëm në mbarim të librit (për nxënësit në klasat, vitet më të larta);
- ▶ ti kushtohet vëmendje pasurimit të fjalorit të nxënësve për lëndën mësimore;
- ▶ të shmangen fjalë të panevojshme të huaja, internacionalizma ose forma tjera gjuhësore, çdo herë kur në gjuhën amtare për këtë ekziston fjalë/term me kuptim të njëjtë;
- ▶ të përdoren shkurtesa, simbole dhe shenja të normuara në standardet e gjuhës në të cilin është shkruar libri (gjuha maqedonishte, gjuha shqipe,

gjuha turke, gjuha serbe ose gjuhë tjetër) si dhe njësitë matëse të dispozitave dhe shkurtesat e tyre.

Përmbajtjet në libër duhet të jenë të bartura në mënyrë të kuptueshme dhe interesante . Duhet të shmangen shprehjet e paqarta (fjalë të panjohura, shprehje të cilat kanë më shumë kuptime, shprehje abstrakte) dhe organizim të komplikuar të fjalisë dhe tekstit.

Fjalja në tekst nuk duhet të jetë shumë e gjatë. Është e preferuar në një fjali të ketë vetëm një nocion të pa njohur dhe një fjali duhet të përmbajë një njësi të njohurisë – pohim themelor logjik.

Gjatë zhvillimit të librit, përmbajtja duhet të pasojë në radhitje logjike të gjendjeve, aksioneve, ndodhive, fjalitë të cilat përdoren në libra me kalimin nga klasat më të ulëta në më të larta duhet të jenë më të gjata dhe më të ndërlikuara nga fjalitë të cilat i përdorin vetë nxënësit, që të mund libri ta nxisë zhvillimin e gjuhës së nxënësve.

Për tu shmangur gjërave abstrakte në të shprehurit dhe teksti të bëhet në përputhje me moshën e nxënësve duhet të përdoren emra të cilët tregojnë punë të njohura, të jepen shembuj konkret për ndonjë rregull ose shembuj nga praktika, të vendoset nxënësi para problemit dhe të theksohet rëndësia e materies që mësohet.

Përmbajtjet në libër do të jenë të pranueshme për nxënësit nëse barten me stil dhe gjuhë e cila përmban fjalë të cilat shpesh përdoren, nëse jep informata të reja, e thekson tërheqjen e temës (raportet midis

njerëzve, ndjenjave, përjetimet e individëve, ngjarjet e rëndësishme). Gjithashtu, tekstin e bën interesant edhe përdorimi i emrave të përveçëm dhe pronor (për shembull: emra dhe mbiemra të individëve) dhe deklarime personale të cilat përfshijnë fjalim të drejtpërdrejtë, përmbajnë pyetje, këshilla, kërkesa, lutje). Në libër duhet të shmangen fjalitë e gjata, fjalët e gjata, përsëritja e emrave të njëjtë, përdorimi shumë i shpeshtë i emrave abstrakt dhe emra që nuk përdoren në gjuhën e të folurit. E domosdoshme është që shprehjet gjuhësore të jenë në përputhshmëri me natyrën e përmbajtjeve dhe nëse është e nevojshme mund të përdoret ndarja grafike dhe theksimi i fjalëve kryesore, ndërsa varësisht nga natyra e përmbajtjeve mund të përdoren edhe më pak forma morfologjike të zakonshme të fjalëve, proverba, fjalëkryqe, rebuse, gojëdhëna, fjalëshpejta, si dhe stili i veçantë ose formë të të shprehurit.

### **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/diturisë, zhvillimit të identitetit nacional dhe qytetar, kulturave të shumta dhe barazisë gjinore**

E domosdoshme është që librat bashkëkohorë të kenë funksion edukativ, ti forcojnë të gjitha vlerësimet pozitive të civilizimit bashkëkohor, ti promovojnë vlerat etike: ndershmëri, realitet, drejtësi, ti nxisin nxënësit në dëshirë

dhe raport pozitiv ndaj punës dhe diturisë, përkryerje të vazhdueshme, ndërtimin e identitetit nacional dhe ti promovojnë dhe zhvillojnë vlerat dhe përfitimet nga jeta e përbashkët dhe respektimi i dallimeve ndërmjet njerëzve (etnike, fetare, gjinore etj), kulturën e tyre, gjuhën dhe traditat.

Gjithashtu, përmes përmbajtjeve në libra duhet të zhvillohet vetëdija tek nxënësit për prejardhjen e tyre kulturore dhe të nxitet interesimi për njohjen e trashëgimisë kulturore të bashkësive tjera.

Për të siguruar me libër, promovimi i respektimit të ndërsjellë dhe pranimi dhe të ndihmohet në integrimin e bashkësive etnike/kulturore në shoqërinë maqedonase, libri bashkëkohor (respektivisht nga shkencat shoqërore-humanitare, mësimi i gjuhëve dhe arteve) duhet ta tregojë Republika e Maqedonisë si shoqëri multikulturore dhe multietnike. Kjo mundëson që me përpunimin e përmbajtjeve, pyetjeve, detyrave, ilustrimeve dhe shtojcave tjera të sigurohet:

- ▶ përpunimi i përmbajtjeve dhe qasjeve të cilat e zhvillojnë identitetin qytetar dhe nacional tek pjesëtarët e bashkësive etnike/kulturore në vendin tonë;
- ▶ prania në libër/dorëshkrimin të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike/kulturore të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë;



- ▶ prezantimi dhe promovimi i interaksionit midis pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike/kulturore në Republikën e Maqedonisë;
- ▶ njohja me historinë, kulturën dhe traditën e bashkësive etnike/kulturore që jetojnë në Republikën e Maqedonisë përmes prezantimit të perspektivës së tyre dhe me njohjen e ndikimit negativ të stereotipeve ekzistuese etnike;
- ▶ prezantimi i specifikave të bashkësive të ndryshme etnike të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë dhe njohja e bazave të përbashkëta të cilat dalin nga ndikime të ndërsjella dhe përzjerja e kulturave në të kaluarën dhe sot.

Nga aspekti i promovimit të barazisë gjinore në libra (në pjesën e përmbajtjeve, pyetjeve, detyrave, ilustrimeve dhe shtojcave tjera) duhet pasur kujdes:

- ▶ shmangia e çfarë do qoftë prodhimit (eksplicite ose implicate) të stereotipeve gjinore;
- ▶ tejkalimi i ndarjes tradicionale të roleve mashkull-femër në shoqëri;
- ▶ Sensibilizimi i barazisë gjinore, si dhe të drejtat dhe liritë e njeriut (zgjedhja e profesionit, bindjes politike, religjionit);
- ▶ Sigurimi, në masë të madhe, prani e barabartë e personazheve mashkullore dhe femërore (ilustrime, tekste, analizë).

## **II. KRITERET PËR PËRGATITJEN E LIBRAVE NË DISA LËNDË TË VEÇANTA NË ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM**

LIBRA PËR LËNDË  
MËSIMORE NË MËSIMIN  
KLASOR (KLASA E I-V)

## Përputhja e përmbajtjes së librit me programin mësimor

- ▶ Libri është në funksion të zotërimit të njohurive dhe shkathtësive të parapara për klasën konkrete.
- ▶ Është i përshtatur me qëllimet edukative-arsimore dhe rezultatet e pritura;
- ▶ Është i përshtatshëm me aktivitetet dhe metodat për punë të parapara me programin mësimor;

## Përmbajtja ndaj të arriturave bashkëkohore të lëmit të caktuar shkencor, metodologjia e mësimit të lëndëve dhe përdorimi i terminologjisë profesionale

### *Bazimi shkencor i përmbajtjeve*

- ▶ Libri duhet të ofrojë njohuri të sakta dhe aktuale
- ▶ Libri duhet të përmbajë sqarime të sakta dhe më të reja shkencore
- ▶ Shembujt e njohurive që ofrohen paraqesin shkencë në vete (të përshtatshme me moshën e nxënësit, por pa gjëra shumë të ashpra).
- ▶ Termet specifike për disiplinën shkencore përdoren në mënyrë adekuate, në përputhshmëri me natyrën e përmbajtjeve përmes të cilave zbatohen.

- ▶ Përmbajtjet janë zgjedhur në mënyrë optimale, gradualisht dhe paraqiten në mënyrë të përshtatshme.

### *Struktura e përmbajtjeve në libër*

- ▶ Libri është mirë i strukturuar dhe e mbështet mësimin nëse ekziston organizim funksional i temave – leksioneve në libër.
- ▶ Me kontrollimin e përmbajtjeve mësohen parimet themelore të organizimit të përmbajtjes mësimore si dhe temat të cilat i përbëjnë elementet më kryesore.
- ▶ Me titujt, nëntitujt dhe në mënyra tjera grafike (ngjyra, lloji dhe madhësia e shkronjave, simboleve) qartë janë treguar tërësitë themelore organizative të librit.
- ▶ Qartë janë treguar pjesët e secilit leksion në veçanti (psh., pjesa hyrëse në të cilën rezymohet ajo që tani më është mësuar, teksti kryesor, rezyme etj).
- ▶ Qartë është treguar ajo që është më shumë dhe ajo që është më pak e rëndësishme (me ngjyrë, me lloj tjetër të shkronjave, me simbole të ndryshme etj.).
- ▶ Libri mundëson lidhshmëri horizontale dhe vertikale të njohurive.
- ▶ Përmbajtjet janë ekspozuar ashtu që mundësojnë lidhshmëri të materialit nga lëndët e afërta.
- ▶ Përmbajtjet janë ekspozuar ashtu që mundësojnë lidhshmëri me materialet nga klasat paraprake dhe ato në vijim (psh., në fillim të njësisë mësimore ku përpunohet një nocion i caktuar, dukuri etj.). (Mblidhet/

sumohet ajo që për të është mësuar në klasat paraprake).

- ▶ Përmbajtjet janë ekspozuar ashtu që tregojnë në përdorimin e mundshëm të njohurisë në jetën e përditshme (përdorimi i njohurive për thyesat, matje e llojeve të ndryshme të përdorimit funksional të gjuhës: si shkruhet letër, ndërsa si lutje; hartimi i planit), si dhe për përvetësimin e njohurive të reja të ndërlikuara.

### *Tekste plotësuese, pyetje dhe detyra*

- ▶ Libri e aktivizon nxënësin dhe e nxitë në mendim kritik dhe krijues.
- ▶ Pyetjet, detyrat dhe kërkesat e nxitin nxënësin të përdorë teknika të ndryshme- lexim, të mbajturit mend, realizim konkret, grumbullim dhe vlerësim individual të informatave nga burime të ndryshme, modelim, planifikim dhe realizim të projekteve të vogla dhe eksperimente.
- ▶ Çdo herë kur është e mundur përmbajtja për mësim „përkthehet” nga një formë në formë tjetër kështu që përmbajtja e njëjtë paraqitet me fjalë, fotografi, skemë, grafikun.
- ▶ Në libër varësisht nga natyra e lëndës dhe e moshës së nxënësit duhet të ekzistojë raport optimal midis tekstit dhe hapësirës i cili është paraparë për punën e nxënësit.

- ▶ Hapësira për punë duhet të jetë e madhe që nxënësi të mund ti përgjigjet kërkesave.
- ▶ Në libër ka kërkesa, pyetje dhe detyra të cilat e nxisin nxënësin ta shprehë qëndrimin e tij (pyetje të hapura të llojit: Çka mendon? Pse kështu mendon? Arsyetoje mendimin tënd? ).
- ▶ Në libër ka kërkesa, pyetje dhe detyra në të cilat nuk ekziston përgjigje e vetme, e as vetëm një zgjidhje, ekzistojnë detyra ku te zgjidhja mund të vihet sipas mënyrave të ndryshme.
- ▶ Në libër ka tekste të cilat përmbajtjet e përpunuara i ndërlidhin me atë që për nxënësit është relevante (psh., në detyrat tekstuale të matematikës përdoren tregime të situatave nga jeta e përditshme të afërta dhe të njohura për nxënësit).
- ▶ Libri ofron njohuri të ndryshme (të llojit „Vallë e dini” „Edhe kjo është matematikë” etj.), të cilat e nxisin dhe e përbushin kureshtjen e nxënësit dhe i ndihmojnë ti mbajë mend idetë kryesore të mësimin.
- ▶ Në libër lehtë gjenden informatat, të përshtatura për nga moshja, ata e bëjnë të pavarur nxënësin dhe e shtrijnë ndjenjën e të arriturave.
- ▶ Librin e këtillë nxënësi e shikon dhe e shfleton edhe kur për këtë nuk ka nevojë të drejtpërdrejtë.
- ▶ Në libër ka pyetje me përgjigje, zgjidhje të sakta dhe komente për llojet e gabimeve dhe njohjen e gabimeve, mundësive për vetëvlerësim.

- ▶ Libri duhet të përdoret edhe pa ndihmën e personit të moshuar (duke i përfshirë librat për nxënësit e klasës së parë.

### *Shtojcat vizuale*

- ▶ Cilësia e librit dhe elementet e dizajnit duhet ta nxitin mësimin dhe përdorimin e tij
- ▶ Fotografitë dhe ilustrimet janë mjaft të mëdha dhe të qarta; nuk ka fotografi, ilustrime të paqarta.
- ▶ Të gjitha ilustrimet kryesisht janë në funksion të tekstit (është paraqitur në mënyrë ilustruese ajo që me fjalë përshkruhet).
- ▶ Libri lejon të shkruarit, shlyerjen dhe nënvizimin (për librat nga klasa e I-III).
- ▶ Libri mundëson kontrollim dhe i përgjigjet moshës së nxënësit.
- ▶ Varësisht nga natyra e lëndës dhe moshës së nxënësve libri kryesor është përcjella me fletore pune, përmbledhje detyrash, poster, CD ose USB, me përmbajtje të xhiruara digjitale, lojëra etj., që nxënësit do ti përdorin në kompjuterët e tyre statik dhe të lëvizshëm.

## **Përshtatja e librit me moshën e nxënësve**

- ▶ Stili i bartjes së përmbajtjeve në libër i përgjigjet fjalorit aktiv dhe pasiv të fëmijës nga mosha e caktuar.
- ▶ Me përdorimin e fjalive të shkurtra mundësohet përcjellja e tekstit.
- ▶ Për fjalët dhe termet e reja dhe të panjohura të nxënësve, sqarimet jepen në margjinat ose në pjesën e posaçme në fund të njësisë mësimore, tërësisë tematike ose në fund të librit.
- ▶ Definicionet e dhëna në librat janë të shkurtra, të qarta dhe të kuptueshme për nxënësit.
- ▶ Në mënyrën e prezantimit të përmbajtjeve niset nga ajo që nxënësit e dinë nga përvoja mësimore dhe jashtëmësimore, dhe ato njohuri më tutje ndërlikohen, thellohen dhe sistematizohen.
- ▶ Ekziston gradualitet në mënyrën e prezantimit të përmbajtjes për mësim (nga e njohura ndaj të panjohurës, nga konkretja ndaj abstraktes).
- ▶ Mënyra e përpilimit të përmbajtjeve dhe detyrave nuk janë aq shumë të lehta (mbajtja e përvojës nuk e tërheq zhvillimin përpara) por nuk janë as shumë të vështira (kërkesa të pakuptimta, dukuri, nocion i panjohur të sqarohet me nocion i cili ende nuk është përpiluar etj).
- ▶ Përmbajtjet dhe mënyra përpilimit i përgjigjen karakteristikave emocionale – sociale të moshës („pikëlluese “ tekstet e lëndës së gjuhës amtare nuk

janë të mira në klasat fillestare, shembujt me të cilat ilustrohen nocionet e përpunuara duhet të jenë të afërta me përvojat dhe interesin e moshës konkrete ).

- ▶ Në libër ekzistojnë detyra diferencuese – përveç atyre që mund ti zotërojnë një numër më i madh i nxënësve, ekzistojnë edhe të atilla për nxënësit të cilët më shpejtë përparojnë.
- ▶ Për nxënësit të cilët më ngadalë përparojnë nga mesatarët, libri ofron detyra plotësuese me nivel më të ulët të kërkesave (ose propozime për metoda specifike, diferencuese dhe teknika të punës me këto nxënës ).

### **Libri ka funksion edukues, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurisë, zhvillimin e identitetit nacional dhe qytetar, kulturave të shumta dhe barazinë gjinore.**

- ▶ Libri i motivon nxënësit.
- ▶ Tekstet dhe fotografitë janë jodiskriminuese sa i përket gjinisë, fesë, përkatësisë etnike dhe çfarëdo qoftë dallimi tjetër që mund të ekzistojë midis njerëzve.
- ▶ Varësisht nga natyra e lëndës, përmbajtjeve dhe mënyrës së prezantimit të tyre është e mundur të ndërtohen vlera siç janë: patriotizmi, sinqeriteti, nderi, brenga për të tjerët, ndjenja, miqësia, dashuria për punë.

- ▶ Varësisht nga natyra e lëndës, përmbajtjet dhe mënyra e prezantimit të tyre kontribuojnë për ruajtjen e identitetit nacional dhe kulturor.
- ▶ Varësisht nga natyra e lëndës, përmbajtjet dhe mënyra e prezantimit të tyre kontribuojnë për promovimin e pranimit dhe respektit të ndërsjellë dhe të ndihmohet në integrimin e bashkësive etnike/kulturore në shoqërinë maqedonase.

KRITERE PËR PËRPILIMIN E LIBRIT TË GJUHËS  
MAQEDONISHTE, GJUHËS SHQIPE, GJUHËS  
TURKE, DHE GJUHËS SERBE NË ARSIMIN  
FILLOR, RESPEKTIVISHT NË GJUHË DHE LETËRSI  
MAQEDONISHTE, GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE, GJUHË  
DHE LETËRSI TURKE NE ARSIMIN E MESËM.

---



## **Përshtatja e përmbajtjes së librit me programin mësimor.**

- ▶ Në bazë të qëllimeve të programeve mësimore të gjuhës maqedonishte, gjuhës shqipe, gjuhë turke, dhe gjuhës serbe (respektivisht gjuhës dhe letërsisë maqedonishte, gjuhës dhe letërsisë shqipe, gjuhës dhe letërsisë turke ) në libër duhet të jenë të zhvilluara përmbajtje nga të gjitha lëmit programore: Gjuhë, letërsi dhe lektyrë, Të shprehurit dhe krijimi dhe Kultura mediale në arsimin fillorë, respektivisht: Gjuhë dhe letërsi për arsimin e mesëm.
- ▶ Përmbajtjet mësimore nga lëmit programore duhet të përfshihen me numër përkatës të orëve, të definuar në programin mësimorë.
- ▶ Libri duhet ti përfshijë dhe përpilojë nocionet të cilët dalin nga përmbajtjet në programin mësimorë.

## **Përmbajtja ndaj të arriturave bashkëkohore të lëmit të caktuar shkencor, metodologjia e mësimimit të lëndëve dhe përdorimi i terminologjisë profesionale**

- ▶ Përmbajtjet në libër duhet të kenë përbërje shkencore dhe logjike sipas zhvillimit bashkëkohor të shkencës për studimin e gjuhës së caktuar.

- ▶ Tekstet në libër duhet të shkruhen në gjuhën letrare të standardizuar në pajtim me drejtshkrimin, lëshime mund të ketë vetëm kur përdoren fragmente nga literatura artistike dhe në tekstet nga dialektologjia.
- ▶ Nocionet duhet gradualisht të aplikohen dhe thellohen në pajtim me metodologjinë e studimit të lëndës mësimore.
- ▶ Libri duhet të përmbajë të dhëna të sakta dhe të kontrolluara dhe informata për nocione dhe përmbajtje të caktuara.
- ▶ Përmbajtjet në libër karakteristike për lëmi të caktuara programore, duhet të jenë bazë për ndërtimin e kulturës gjuhësore.
- ▶ Libri duhet të ofrojë forma të ndryshme të aktiviteteve përmes të cilave nxënësit do ti nxisë të mendojnë në mënyrë kritike dhe të arrijnë deri te konkluzionet dhe njohuritë përkatëse.
- ▶ Në libër duhet të ketë detyra, ushtrime dhe aktivitete të cilat do të mundësojnë diturinë që e fitojnë nxënësit ta zbatojnë në detyra të ngjashme ose të reja dhe ushtrime.
- ▶ Për sqarimin e nocioneve/fjalëve të panjohura në fund të librit është e obligueshme të ketë fjalor për interpretimin e nocioneve/fjalëve të panjohura.
- ▶ Libri duhet të përmbajë edhe informata për zgjerimin e interesave dhe njohurive të nxënësve të cilat për kohë të shkurtë më shpejtë dhe më lehtë i përfitojnë njohuritë.

- ▶ Ilustrimet dhe tekstet duhet të jenë në korrelacion me përmbajtjet në programin mësimor dhe me nocione të cilat përpilohen. Në arsimin e mesëm vëllimi i ilustrimeve duhet të zvogëlohet në dobi të teksteve plotësuese.
- ▶ Gjatë parashtrimit të detyrave për kontrollimin e njohurive të fituara të përdorin detyra të nivelit me peshë të ndryshme dhe llojit të ndryshme.

### **Përshtatja e librit me moshën e nxënësit**

- ▶ Libri duhet të jetë i përshtatur me moshën e nxënësve dhe pastaj të ketë kujdes në aftësitë intelektuale të cilat janë të nevojshme për mësim dhe përvetësimin e përmbajtjeve.
- ▶ Libri duhet ti mundësojë nxënësve vetëarsimim dhe krijim të shprehive për njohuri afatgjate.
- ▶ Përmes mënyrës së zgjedhjes së temave, përmbajtja dhe radhitja e tyre e vendosjes së informatave të mundësohet mbi ndërtimin e njohurive.
- ▶ Të ketë lidhshmëri të qartë dhe logjike në nocionet e sapomësuara dhe rregullave drejtshkrimore me njohurinë paraprake të nxënësve.
- ▶ Gjatë zgjedhjes së përmbajtjeve, vëllimi i tyre, mënyra e sistematizimit dhe thellimit, duhet pasur kujdes në mundësitë zhvillimore të nxënësve. Në arsimin e

mesëm vëllimi i përmbajtjeve dhe teksteve duhet të jetë më i madh dhe të shkruhet me stil më të lartë.

- ▶ Varësisht nga moshja e nxënësve, në libër duhet të ketë shtojca përkatëse vizuale: fotografi, reproduksione të veprave artistike, piktura për fëmijë, skema, fotografi, grafikone dhe ilustrime të cilat e përcjellin tekstin.

Përfaqësimi i shtojcave vizuale në libër për arsimin e mesëm duhet të jetë më i vogël.

- ▶ zgjedhja përkatëse e përmbajtjeve të ndikojë ndaj pasurimit të fjalorit të nxënësve.
- ▶ Varësisht nga moshja mund të përdoren edhe shprehje më të vogla të rëndomta: gjëegjëza, fjalëshpejta, gojëdhëna, fjalëkryq, rebuse si dhe stil i veçantë ose formë të shprehjes për arsimin fillor, kurse në librat për arsim të mesëm këto shprehje nuk janë të nevojshme.
- ▶ Përmes zgjedhjes përkatëse dhe përpilimit të përmbajtjeve dhe sistematizimit të tyre sipas lëmive programore, libri duhet ti nxisë proceset e krijuara dhe aftësitë tek nxënësit.

**Libri ka funksion edukativ, e nxitë raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurisë, zhvillimit të identitetit nacional dhe qytetar, kulturave të shumta dhe barazisë gjinore**

- ▶ Libri duhet ti nxisë nxënësit të zhvillojnë kulturë në të lexuarit dhe raport pozitiv ndaj literaturës.
- ▶ Libri duhet të ndihmojë në shprehjen e qëndrimeve personale, mendimit kritik dhe shkathtësive për shprehje gojore dhe me shkrim.
- ▶ Të zhvillohet interes dhe respekt për kulturën dhe traditën tënde dhe të tjerëve të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë.
- ▶ Në libër të ketë përmbajtje të cilat japin bazë për tu njohur të tjerët, rregullat e sjelljes dhe të drejtat e njeriut, zhvillimi i interesimit dhe respektit ndaj kulturës dhe traditës tënde dhe të tjerëve.
- ▶ Nëse me programin mësimor përpunohet krijimtari popullore (përralla popullore, gojëdhëna, gjëgjëza dhe krijime tjera popullore) në libër duhet të jetë e përfaqësuar krijimtaria popullore e bashkësive të ndryshme etnike/kulturore në Republikën e Maqedonisë.
- ▶ Nëse personazhet në tekstet e librave tregohen në role stereotipe gjinore, diskutimet/detyrat të cilat ndihmojnë për përpunimin e përmbajtjeve mësimore kërkojnë të tregohen stereotipet e tyre, të analizohen rrënjët e tyre dhe të tregohet ndikimi i tyre negativ ndaj raporteve midis gjinive.

GJUHA MAQEDONISHTE PËR  
BASHKËSITË/GJUHA DHE  
LETËRSIA MAQEDONISHTE  
PËR BASHKËSITË

---

## **Përshtatja e përmbajtjes së librit me programin mësimor.**

- ▶ Përmbajtjet në librin e gjuhës maqedonishte, respektivisht gjuha dhe letërsia maqedonishte për bashkësitë duhet të zhvillohen në pajtim me qëllimet e të gjitha lëmive programore: Gjuhë, letërsi dhe lektyrë, Të shprehurit dhe krijimi për arsimin fillorë, respektivisht: Gjuhë maqedonishte dhe letërsi maqedonishte për arsimin e mesëm.
- ▶ Libri duhet ti përfshijë dhe përpilojë nocionet të cilat dalin nga përmbajtja e programit mësimor.
- ▶ Përmbajtjet e zgjedhura në libër ta përcjellin radhitjen logjike të programit mësimor.
- ▶ Numri i përmbajtjeve mësimore ti përgjigjet qëllimeve të definuara sipas lëmive mësimore.

## **Përmbajtja ndaj të arriturave bashkëkohore të lëmit të caktuar shkencor, metodologjia e studimit të lëndëve dhe përdorimi i terminologjisë profesionale.**

- ▶ Libri të shkruhet në gjuhën e standardizuar maqedonishte në pajtim me drejtshkrimin. Lëshime mund të ketë vetëm kur përdoren fragmente nga literatura artistike dhe nga tekstet e dialektologjisë.

Zgjedhja e përmbajtjeve të ketë bazë shkencore dhe logjike sipas zhvillimit bashkëkohor të shkencë për gjuhë maqedonishte.

- ▶ Libri duhet ti aftësojë nxënësit për përdorimin e të gjitha shkathtësive gjuhësore (dëgjim me kuptim, lexim me kuptim, të folurit dhe të shkruarit).
- ▶ Libri të ofrojë përvetësim gradual dhe sistematik të nocioneve dhe rregullave të ndërlidhura me drejtshkrimin dhe drejtshkrimin e gjuhës së standardizuar maqedonishte.
- ▶ Vëmendje e posaçme ti kushtohet ushtrimeve në të cilat rregullat dhe nocionet e përvetësuara do të jepen në situata të ngjashme ose të reja.
- ▶ Varësisht nga qëllimet programore mund të përdoren: gjëegjëza, fjalëshpejta, gojëdhëna, fjalëkryqe dhe rebuse.
- ▶ Përvetësimi i nocioneve të reja ti përshtatet nevojave dhe karakteristikave zhvillimore të nxënësve.
- ▶ Nocionet e reja në përmbajtjet e librit të theksohen (me nënvizim, të theksuara me ngjyra, dhe të vendosura në kornizë etj).
- ▶ Përmbajtjet në libër duhet të mundësojnë përdorim receptiv dhe produktiv të gjuhës maqedonishte në njoftimin me gojë dhe me shkrim.
- ▶ Përmbajtjet në libër ti zhvillojnë aftësitë dhe shprehitë për përjetimin dhe kuptimin e tekstit të literaturës.

- ▶ Përmbajtjet e librit ta nxisin mendimin kritik të nxënësve.
- ▶ Aparatura didaktike të jetë në përputhje me kërkesat bashkëkohore për mësim aktiv dhe kreativ.
- ▶ Në fund të përmbajtjes të librit është e obligueshme të ketë fjalor për interpretim të fjalëve të panjohura ose më pak të njohura.

## **Përshtatja e librit me moshën e nxënësve**

- ▶ Përmbajtjet e teksteve të jenë të përshtatshme me karakteristikat zhvillimore të nxënësit.
- ▶ Libri të ofrojë pasurim pak nga pak të fjalorit të nxënësit me fjalë të reja.
- ▶ Libri nxënësve duhet t'iu mundësojë krijimin e shprehive për vetë arsimim dhe përvetësim afatgjatë të njohurive.
- ▶ Në përputhje me moshën e nxënësve, libri duhet të përmbajë shtojca përkatëse vizuale, piktura, riprodhime të veprave artistike, vizatime për fëmijë, skema, fotografi dhe ilustrime të cilat e përcjellin përmbajtjen e tekstit.

## **Libri ka funksion edukativ, e nxitë raportin pozitiv ndaj shkencës/ diturisë, zhvillimit të identitetit nacional dhe qytetar, kulturave të shumta dhe barazisë gjinore**

- ▶ Në libër të jepen tekste përmes të cilave nxënësit nga bashkësitë tjera do të njihen me trashëgiminë historike dhe kulturore maqedonase.
- ▶ Libri duhet ti nxisë nxënësit të zhvillojnë kulturën e të lexuarit dhe raport pozitiv ndaj literaturës;
- ▶ Libri duhet të ndihmojë në shfaqjen e qëndrimeve personale, mendimit kritik dhe shkathtësive për të shprehurit gojor dhe me shkrim;
- ▶ Të zhvillohet interesim dhe respekt për kulturën dhe traditën e vet dhe të tjerëve të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë;
- ▶ Në libër të ketë përmbajtje të cilat japin bazë për njohjen e të tjerëve, rregullat e sjelljes dhe të drejtave të njeriut, zhvillimi i interesimit dhe respektit ndaj kulturës dhe traditës së vet dhe të tjerëve;
- ▶ Nëse me programin mësimor përpunohet krijimtari popullore (përralla popullore, gojëdhëna, gjëgjëza dhe krijime tjera popullore tjera) në libër duhet të përfaqësohet krijimtaria popullore e bashkësive të ndryshme etnike/kulturore në Republikën e Maqedonisë;

- ▶ Nëse personazhet në tekstet e librave prezantohen në rolin gjinor të stereotipeve, diskutimet/detyrat të cilat ndihmojnë për përpilimin e përmbajtjeve mësimore kërkojnë të tregohen stereotipi i tyre, të analizohen rrënjët e tyre dhe të tregohet ndikimi i tyre negativ ndaj marrëdhënieve midis gjinive;

# MATEMATIKA

---



## Përshtatja e përmbajtjes së librit me programin mësimor

Libri i matematikës duhet me besueshmëri ta interpretojë programin mësimor të matematikës për klasën përkatëse në arsimin fillor nëntëvjeçar (I-IX), respektivisht për vitin përkatës të mësimit (I-V) në arsimin e mesëm (gjimnaz dhe arsim të mesëm profesional) edhe atë sipas:

- ▶ qëllimeve mësimore;
- ▶ nocioneve dhe përmbajtjeve;
- ▶ fondit të orëve;
- ▶ moshës së nxënësve;
- ▶ krijimi profesional, shkencor dhe didaktike-metodike;
- ▶ korrelacioni me lëndë dhe lëmi tjera;
- ▶ standardet gjuhësore, estetike, figurative dhe grafike;

## Përmbajtja ndaj të arriturave bashkëkohore të lëmit të caktuar shkencor, metodologjia e mësimit të lëndës dhe përdorimi i terminologjisë profesionale

- ▶ Libri i matematikës duhet të përmbajë nocione, procedura dhe teknika për zgjidhjen e problemeve të mundësojë zhvillim të shkathtësive për përllogaritje dhe ta nxitë zhvillimin e të menduarit;

- ▶ Libri i matematikës duhet të jetë në funksion të mësimi, në përfitimin e njohurive dhe shkathtësive, të zbatimit të tyre, si dhe në funksion të zhvillimit të kreativitetit të nxënësit;
- ▶ Libri i matematikës duhet të përmbajë mësim përmes zbulimit, përmes hulumtimit dhe përmes zgjidhjes së problemeve;
- ▶ Libri i matematikës mundëson qasje konstruktive gjatë përfitimit të njohurive dhe shkathtësive të nxënësve, dmth., nxënësi të fitojë njohuri dhe shkathtësi përmes angazhimit të vet;
- ▶ Libri i matematikës duhet të mundësojë kontrollim (vetëkontrollim) të të arriturave të nxënësve për secilën temë përmes pyetjeve dhe detyrave nga ajo temë, ashtu që do të mundësojnë kontrollimin e aftësive dhe diturive të përfituara të niveleve të ndryshme kognitive;
- ▶ Libri i matematikës duhet ti merr parasysh format e ndryshme të aktiviteteve për përfitimin e shkathtësive dhe njohurive për nocione të ndryshme në tekstin kryesor, kështu që nocionet, procedurat, proceset të përpunohen në tërësi përkatëse të rrumbullakuara (pjetave);
- ▶ Teksti në librin e matematikës të mundësojë lidhshmëri të përmbajtjeve mësimore (leksionet) në kuadër të një teme, dmth., përmbajtja mësimore të përmbajë pjesë përgatitore për përvetësimin e nocioneve të reja në të;

- ▶ Në librin e matematikës detyrat dhe pyetjet në fund të përmbajtjes mësimore (leksioni) të radhiten sipas niveleve të kërkesave kognitive- nga niveli i memorimit deri te niveli i praktikimit të matematikës;
- ▶ Libri i matematikës duhet të përmbajë vizatime, ilustrime, skema, grafikone, diagrame dhe të ngjashme, që do ta bëjnë të qartë, të kontrolluar dhe tërheqës, veçanërisht librat të dedikuara edhe për nxënësit e periudhës së parë të arsimit fillor nëntëvjeçar.
- ▶ Libri i matematikës duhet të përmbajë vizatime inventive, skema dhe të ngjashme të cilat nxisin në aktivitete mendore për zbulimin, zbatimin dhe të ngjashme, veçanërisht librat e dedikuara për nxënësit e periudhës së parë të arsimit fillor nëntëvjeçar;
- ▶ Libri i matematikës duhet të sillet dhe të përmbajë mësimin e të gjitha kategorive të nxënësve (nga nxënës me të arritura të vogla deri te nxënës më përparimtar );
- ▶ Libri i matematikës duhet t’iu mundësojë nxënësve të përfitojnë njohuri individuale ose në grup;
- ▶ Në librin e matematikës duhet të jepen përgjigjet dhe zgjidhjet e detyrave dhe kontrollimi i nocioneve;
- ▶ Teksti në librin e matematikës përmban shprehje të mirë gjuhësore me përdorimin e termeve dhe simboleve matematikore;

- ▶ Teksti në librin e matematikës siguron aplikimin pak nga pak të nocioneve, veçanërisht të atyre të ndërlikuara;

## **Përshtatja e librit me moshën e nxënësve**

- ▶ Teksti në librin e matematikës duhet të jetë i kuptueshëm dhe tërheqës; të korrespondojë me realitetin; të përmbajë fjali me kuptim, të qarta, koncize dhe të kuptueshme me gjuhë (letrare) standarde;
- ▶ Teksti në librin e matematikës i dedikuar për nxënësit e ciklit të parë të arsimit fillor nëntëvjeçar duhet të përmbajë (fjali kryesore, të shkurta të cilat kanë së paku një informatë);
- ▶ Teksti në librin e matematikës i dedikuar për nxënësit të ciklit të dytë dhe të tretë të arsimit fillor nëntëvjeçar, si dhe libri për nxënësit e arsimit të mesëm të përmbajë fjali të shkurta ose të gjata, por më pas fjalitë e gjata të jenë të qarta dhe të padyshimta, dmth., ta lehtësojnë kuptimin e tekstit;
- ▶ Libri i matematikës duhet të jetë i përshtatshëm me moshën e nxënësit dhe ti mundësojë vetëarsimim dhe krijim të shprehive për mësim të përjetshëm.
- ▶ Libri i matematikës duhet të jetë i përshtatshëm me moshën e nxënësit dhe ti mundësojë të përfitojë

njohuri dhe shkathtësi për përdorimin e algoritmeve, për njoftim, për zgjidhjen e problemeve , me çka zhvillohet kuptimi për mjedisin dhe për botën.

## **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ diturisë, zhvillimit të identitetit nacional dhe qytetar, kulturave të shumta dhe barazisë gjinore**

- ▶ Libri i matematikës përmban aktivitete që e bëjnë tërheqës për nxënësin, respektivisht përmban monolog të nxënësit ose të mësimdhënësit ose dialog lidhur me nocionet dhe procedurat apo veprimet.
- ▶ Libri i matematikës në pyetjet dhe në detyrat problemore, të ndërlidhura me persona ose vende në Republikën e Maqedonisë siguron prezencë të personazheve mashkullore dhe femërore (emra të ilustrimeve ose të dyja) të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike ose kulturore të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë.
- ▶ Libri i matematikës në më shumë pyetje dhe detyra problemore në të cilat janë të pranishëm përfaqësuesit e bashkësive të ndryshme etnike/kulturore, i tregon personazhet si pjesëmarrës në ndodhi të përbashkëta, kurse jo si pjesëmarrës në ndodhi të veçanta ose paralele.

# HISTORIA

---

## Përshtatja e përmbajtjes së librit me programin mësimor

- ▶ Libri i historisë duhet të del nga programi mësimor i historisë.

## Përmbajtja ndaj të arriturave bashkëkohore të lëmit të caktuar shkencor, metodologjia e mësimin të lëndës dhe përdorimi i terminologjisë profesionale

- ▶ Nxënësit të përfitojnë njohuri të vërtetuara thelbësore, sistematike dhe shkencore për të kaluarën dhe të tanishmen të cilat do të kontribuojnë në ndërtimin e sistemit të vlerës të sjelljes ndaj shtetit të tyre.
- ▶ Nxënësit të përfitojnë njohuri për të arriturat e përgjithshme civilizuese në botë dhe ta thellojnë interesimin për mësimin e mëtutjeshëm të proceseve dhe ngjarjeve historike.
- ▶ Pika kryesore kaluese e librit të jetë Republika e Maqedonisë dhe historia e cila ka ndodhur në Maqedoni.
- ▶ Të respektohen përfitimet nga të gjitha bashkësitë etnike të cilat kanë marrë pjesë në ndërtimin e shtetit Republika e Maqedonisë si shtet i përbashkët i të

gjithëve (në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë).

- ▶ Historia politike të përfaqësohet në mënyrë të barabartë me historinë kulturore , shoqërore, ekonomike të jetës së përditshme.
- ▶ Të respektohet raporti midis teksteve, ilustrimeve dhe detyrave për nxënësit.
- ▶ Tekstet nuk duhet të jenë monotone për nxënësit, nuk duhet ti ngarkojnë me të dhëna të panevojshme dhe jo thelbësore, por mësimi i historisë duhet të jetë argëtues dhe ti nxitë në të menduarit.
- ▶ Në secilën nga përmbajtjet duhet të ketë sqarim të nocioneve të reja në përputhje me moshën e nxënësit.
- ▶ Rregullat për përpilimin e librit duhet të paraqesin zhvillim strukturor të ndërlidhur dhe dalëngadalë të përmbajtjeve historike të përcjella me shembuj.
- ▶ Informatat të cilat janë prezantuar duhet të mundësojnë mënyrë interaktive të punës .
- ▶ Duhet të ketë kujdes në përfaqësimin e të gjitha periudhave nga historia, nga parahistoria deri më sot, pa mos i dhënë rëndësi të madhe ose të vogël periudhave të caktuara historike.
- ▶ Në përmbajtjet duhet të përfaqësojnë të gjitha nivelet e njohurive: të mbajturit mend (reproduksioni i thjeshtë), kuptimi (të kuptuarit) dhe nivelet më të larta të njohurive (aplikimi, analizë, sintezë).

- ▶ Përmbajtjet në libra duhet të jenë në korrelacion me lëndët e ngjashme mësimore çdo herë kur ekziston mundësi për këtë.
- ▶ Për ti mësuar më lehtë disa pjesë të përmbajtjeve mund të përdoren mjete të ndryshme grafike: theksimi me ngjyra, nënvizimi, shkurtimi ose radhitja e tekstit, përdorimi i nëntitujve, skemave etj.
- ▶ Materiali didaktik të cilin duhet ta përcjell secili nxënës gjatë përpilimit të përmbajtjeve mund të përmbajë pyetje, detyra, fotografi, ilustrime, piktura, grafikone, harta historike, tabela kronologjike dhe ato duhet të jenë sa më shumë të përfaqësuara në përputhje me përmbajtjen e cila përpilohet.
- ▶ Pyetjet dhe detyrat duhet të formulohen në atë mënyrë që do të nxisin mendim të hapur dhe kritik si dhe aftësi për të analizuar proceset historike.

### **Përshtatja e librit me moshën e nxënësve**

- ▶ Vëllimi i teksteve dhe numri të dhënave veçanërisht i ngjarjeve, vendeve dhe datave të jenë përkatëse me moshën e nxënësve. Fjalitë të cilat përdoren në librat e historisë me kalimin prej klasave të ulëta në ato të larta duhet të jenë më të gjata dhe më të ndërlikuara nga fjalitë të cilat i përdorin vetë nxënësit, që të mund libri të nxitë zhvillimin e gjuhës së nxënësve. Megjithatë, fjalitë nuk duhet të jenë të gjata dhe ta vështirësojnë kuptimin e materialit.

- ▶ Në shkallët më të larta të arsimit (arsimit të mesëm) përmbajtjet në histori duhet të jenë më voluminoze, më përmbajtjesore, ta përthellojnë njohurinë e nxënësit dhe të krijojnë mundësi për hulumtim dhe për diskutime në tema të caktuara. Teksti historik në këto libra duhet ti motivojë nxënësit në punë të pavarur dhe ardhja deri te përmbylljet logjike historike për dukuritë dhe proceset.

### **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurisë, zhvillimin e identitetit nacional dhe qytetar, kulturave të shumta dhe barazisë gjinore**

- ▶ Në përmbajtjet duhet të përfshihen kultura të shumta dhe toleranca, para së gjithash përmes kriterëve në vijim:
- ▶ Gjatë dëftimit të historisë të bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë në Republikën e Maqedonisë theksohet roli i tyre në historinë e shtetit, e jo vetëm në historinë e bashkësisë etnike.
- ▶ Në libër janë të pranishëm përmbajtje (tekste dhe ilustrime) të cilat e tregojnë historinë, kulturën dhe traditën e të gjitha bashkësive etnike/ kulturore që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.

- ▶ Ngjarjet historike në të cilat kanë marrë pjesë bashkësitë e ndryshme etnike të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë prezantohen si ngjarje të përbashkëta në njësinë e njëjtë mësimore, ndërsa jo të ndara si njësi të veçanta mësimore në kuadër të temës.
- ▶ Ngjarjet historike në të cilat kanë marrë pjesë bashkësi të ndryshme etnike të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë prezantohen si ngjarje e përbashkët dhe pastaj theksohen synimet e përbashkëta dhe/ose të ngjashme të bashkësive të ndryshme etnike.
- ▶ Në mënyrë përkatëse duhet të prezantohen përmbajtjet të cilat kanë të bëjnë me rolin dhe rëndësinë e gruas në shoqëri në periudha të ndryshme historike.
- ▶ Gjuha e cila përdoret duhet të lirohet nga termet dhe shprehjet të cilat theksojnë urrejtje dhe krijim të fotografisë për armik, respektivisht terminologjia duhet të jetë përkatëse me kohën për të cilën flitet.

GJUHA E HUAJ

---



## Përshtatja e përmbajtjes së librit me programin mësimor

- ▶ Libri i gjuhës së huaj (gjuhë angleze, gjuhë gjermane, gjuhë frënge ose gjuhë ruse duhet të dalë nga plani mësimor dhe programi mësimor i gjuhës së huaj (për klasë përkatëse ose viti i mësimi).
- ▶ Përmbajtjet duhet të jenë të organizuara në tërësi të cilat japin mundësi për mësim komplementar të gjuhës. Secila tërësi të ketë përmbajtje nga secila komponentë e gjuhës, në pajtim me programet mësimore.
- ▶ Materiali didaktik i gjuhës së huaj përveç librit duhet të përmbajë: doracak për mësimdhënësin, fletore pune për nxënësit dhe përmbajtje digjitale.
- ▶ Ushtrimet dhe detyrat të cilat janë pjesë përbërëse e librit dhe fletores së punës duhet të mundësojnë qasje integrale në mësim.

**Përmbajtja ndaj të arriturave bashkëkohore të lëmit të caktuar shkencor, metodologjia e mësimi të lëndës dhe përdorimi i terminologjisë profesionale.**

- ▶ Respektimi i kaheve nga Korniza referente e përbashkët evropiane për gjuhët, e cila dallon gjashtë nivele të përdorimit komunikues të gjuhës së huaj.
- ▶ Nxënësit përmes përmbajtjeve në libër duhet të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim receptiv dhe produktiv të gjuhës së huaj në kontekst gojor dhe me shkrim.
- ▶ Libri duhet ti aftësojë nxënësit për përdorimin e të gjitha shkathtësive gjuhësore (dëgjim me kuptim, lexim me kuptim, të folurit dhe të shkruarit).
- ▶ Përmbajtjet e gramatikës duhet të përfaqësohen në secilën tërësi dhe të jenë në funksion të përvetësimit të shkathtësive gjuhësore.

## Përshtatja e librit me moshën e nxënësve

- ▶ Pika kryesore vijuese e librit është respektimi i kaheve nga Korniza referente e përbashkët evropiane për gjuhët, e cila dallon gjashtë nivele të përdorimit komunikues të gjuhës së huaj dhe ajo të jetë e përshtatshme në përputhje me moshën e nxënësve dhe nivelin e studimit të gjuhës (përmbajtje përkatëse, ilustrime, gjuhë, stil, pyetje dhe detyra).

## **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurisë, zhvillimin e identitetit nacional dhe qytetar, kulturave të shumta dhe barazisë gjinore**

- ▶ Në kuadër të tërësive duhet të integrohen përmbajtje të aspektit të kulturave të shumta dhe aurikulareve të shumta që do të mundësojë korrelacion me lëndë tjera mësimore.
- ▶ Të trajtohen tema të kulturës me qëllim të krijimit të sensibilizimit për mësimin e dallimeve dhe ngjashmërive kulturologjike si bazë për zhvillimin e tolerancës dhe simpatisë ndaj tjetrit dhe të ndryshmit.
- ▶ Të përpilohen përmbajtje përmes të cilave do të përvetësohen kompetenca ndërkulturore për sjellje.
- ▶ Të përmbajnë tekste të cilat do të mundësojnë krahasim dhe socializim të kulturës maqedonase me kulturat tjera.
- ▶ Tekstet duhet të jenë aktuale dhe të përshtatshme për moshën dhe interesat e nxënësve.



# BIOLOGJIA

---

## Përshtatja e përmbajtjes së librit me programin mësimor

- ▶ Qëllimet dhe përmbajtja e përgjithshme e tekstit në libër duhet të jetë në pajtim me programin mësimor dhe standardet mësimore.
- ▶ Titujt dhe numri i temave mësimore të programit mësimor duhet të jenë përkatës me titujt dhe numrin e kapitujve në libër (me harmonizim profesional dhe metodik).
- ▶ Titujt dhe numri i përmbajtjeve mësimore në secilin kapitull të librit duhet ti përgjigjen qëllimeve konkrete të programit mësimorë dhe ta pasqyrojnë numrin e orëve për përmbajtje të reja mësimore.
- ▶ Secila përmbajtje mësimore duhet të ketë kuptim kryesor/ më të rëndësishëm e cila është përkatëse me qëllimet e zgjedhura të programit mësimor dhe kjo duhet të jetë lëndë e sqarimit/ilustrimit dhe parashikimit të aktiviteteve përkatëse.
- ▶ Secila përmbajtje mësimore duhet të shoqërohet me aktivitete përkatëse të shkruara dhe/ ose të skicuara, hulumtime, eksperimente të cilat i përgjigjen qëllimeve të programit mësimor.
- ▶ Secila përmbajtje mësimore përfundon me rezyme të shkurtër të njohurive të reja të cilat e pasqyrojnë kuptimin kryesor të përmbajtjes mësimore.

- ▶ Ndaj secilës përmbajtje mësimore janë dhënë pyetje të cilat janë të ndërlidhura me përmbajtjen e re dhe rezultatet e pritura sipas programit mësimor dhe standardeve arsimore.

## Përmbajtja ndaj të arriturave bashkëkohore të lëmit të caktuar shkencor, metodologjia e mësimit të lëndës dhe përdorimi i terminologjisë profesionale.

- ▶ Libri duhet të përmbajë dëshmi shkencore korrekte dhe interpretime për objektet, kushtet, proceset dhe fenomenet në botën e gjallë.
- ▶ Teksti në libër duhet të jetë autentik dhe origjinal.
- ▶ Libri duhet të ofrojë vetëm njohuri bashkëkohore dhe të dhëna të azhurnuara për botën e gjallë.
- ▶ Të gjitha sqarimet, të dhënat dhe faktet të cilat janë prezantuar në libër duhet të jenë të përfaqësuara përmes qasjes ndërdisiplinore, veçanërisht me shkencat tjera natyrore.
- ▶ Në libër duhet të përpunohen dhe sqarohen nocionet dhe lidhshmëria e tyre reciproke sipas programit mësimor, me çka do të respektohet karakteri i përgjithshëm arsimor i biologjisë dhe do të shmangeshin ngarkesat eventuale të pa nevojshme me

nocione të shkencave aplikative (shkencat mjekësore, veterinare, bujqësore, biologjike - teknologjike etj).

- ▶ Prezantimi i përmbajtjeve duhet të jetë i qartë dhe ekzakt.
- ▶ Secila përmbajtje mësimore duhet të jetë e shoqëruar me shembuj përkatës të shkruar dhe/ose të skicuar, aktivitete/ hulumtime/ eksperimente, të cilat janë marrë nga jeta e përditshme dhe të cilat janë në funksion të karakterit eksperimental të mësimin të biologjisë.
- ▶ Në përmbajtjet mësimore duhet të ketë modele të shumëllojshme të aktiviteteve dhe nivele të ndryshme të peshës.
- ▶ Të gjitha pyetjet e prezantuara duhet të formulohen sipas standardeve arsimore me nivele të ndryshme të peshës, në funksion të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara në biologji, me çka veçanërisht rekomandohen pyetje të cilat nxisin mendim kritik ose parashetrojnë para nxënësit/nxënëses situatë problemore në të cilën do ta zbatojë njohurinë e vet të re.

## Përshtatja e librit me moshën e nxënësve

- ▶ Qasja/kuptimi i përmbajtjeve duhet të jetë në maksimum i përshtatshëm me moshën e nxënësve (nocione dhe terme shkencore, dëshmi, definicione, sqarime).
- ▶ Në librat e biologjisë e një rëndësie të madhe është mirë të ketë përdorim të matur të emrave latin dhe emra tjerë të huaj të objekteve dhe proceseve, sipas moshës së nxënësve.
- ▶ Të gjitha udhëzimet dhe procedurat për aktivitetet dhe tekstet plotësuese duhet të jenë të kuptueshme për nxënësit që ata të mund ti përpunojnë dhe përdorin.
- ▶ Teksti në libër (stili, gjatësia e fjalisë, terminologjia profesionale) duhet të jetë e kuptueshme dhe në përputhje me interesat dhe nevojat e nxënësve.
- ▶ Libri duhet të përmbajë ilustrime të qarta, të kuptueshme dhe të kontrolluara të cilat e mbajnë tekstin dhe të cilat janë të përshtatshme me moshën e nxënësve.
- ▶ Secili ilustrim duhet të ketë funksion të tij në procesin e të mësuarit dhe ti përgjigjet në mundësitë e njohurive të moshës së nxënësit, të shënohet qartë, thjeshtë i numërtuar dhe me titull të kuptueshëm.

## **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurisë, zhvillimin e identitetit nacional dhe qytetar, kulturave të shumta dhe barazisë gjinore**

- ▶ Në librin e biologjisë duhet të theksohet aspekti edukues i biologjisë ( mos dhuna dhe mos diskriminimi i çfarëdo lloji ndaj njerëzve të tjerë përmes sqarimeve për lidhshmërinë biologjike të të gjithë njerëzve ).
- ▶ Në libër duhet të ketë dëshmi të theksuara për përkatësinë e njeriut ndaj llojit biologjik më të zhvilluar i cili e ka edhe përgjegjësinë më të madhe për ekzistimin e jetës në Tokë.
- ▶ Libri nuk duhet të përmbajë përshkrim të ushtrimeve të dy seksioneve të kafshëve, bërja e koleksioneve të insekteve ose shkatërrimi i bimëve të rralla (p.sh, për „përmbledhje” )
- ▶ Teksti duhet të udhëzojë në përgjegjësinë për kafshët dhe bimët, ruajtjen e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit jetësor, mbajtjen dhe kuptimin e llojllojshmërive në natyrë, si dhe përdorimin dhe kursimin me mend të resurseve dhe lëndëve të ndryshme.
- ▶ Libri duhet të udhëzojë në aktivitete dhe kujdes të përditshëm për higjienën dhe shëndetin e tij, si dhe për shëndetin e më të afërmeve.

- ▶ Libri duhet zëshëm të udhëzojë në parandalimin e sëmundjeve ngjitëse të sistemeve të ndryshme organike dhe organizmit si tërësi.
- ▶ Libri i biologjisë (sipas moshës dhe programit mësimor) duhet të prezantojë informata të qarta, udhëzime dhe këshilla për zhvillimin e gjinisë të të gjithë organizmat, e veçanërisht të burri/gruaja, dallimet në gjini, për reproduksionin, mbrojtjen nga shtatzënia, planifikimin e familjes dhe për prindër të përgjegjshëm.
- ▶ Libri i biologjisë (sipas moshës dhe programit mësimor) duhet të përmbajë argumente të qarta (anatomike, fiziologjike, gjenetike, evolutive) për barazinë gjinore.

KIMIA

---



## Përputhja e përmbajtjes së librit me programin mësimor

- ▶ Kusht kryesor është që libri të jetë në përputhje me programin mësimor në aspekt të: qëllimeve, përmbajtjeve me emërim adekuat, renditje për realizimin e përmbajtjeve ( në vëllim dhe thellësi), aktivitete adekuate etj.
- ▶ Libri si mjet themelor për mësim, studim dhe verifikim duhet të mundësoj prezantim të informatave, nocioneve, ligjshmërive, në pajtim me programin mësimor, në funksion të kuptimit të botës së kimisë, arritjen e qëllimeve konkrete mësimore, respektivisht prezantim dhe sqarim të termeve të përshkruara, me mundësi për verifikim të tyre dhe aplikim, si dhe vetëvlerësim të përparimit individual.

## Përqendrimi ndaj të arriturave bashkëkohore të lëmisë së caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës dhe përdorimi i terminologjisë shkencore

Të kuptuarit bashkëkohor të kimisë si shkencë dhe mësimi i lëndës së kimisë është përcaktimi se çdo nxënësi i nevojitet arsimim nga lëmi e kimisë e cila i mundëson ti sqaroj diçka nga mjedisi që e rrethon, e përgatit për punë

të sigurt gjatë përdorimit të prodhimeve kimike në jetën e përditshme, sjellja me kujdes dhe përgjegjësi ndaj vetes dhe natyrës.

- ▶ - Libri i kimisë duhet të jetë në pajtim me parimet dhe kriteret themelore pedagogjike -psikologjike dhe didaktike - metodike: shkencë dhe njohje, mbikëqyrje dhe aktivitet, qasje, logjikë dhe sistematizim.
- ▶ - Niveli shkencor dhe profesional i librit parasheh shfrytëzim të obligueshëm të: terminologjisë shkencore, sistem ndërkombëtar të njësive, IUPAC nomenklatura për komponimet organike, nomenklatura e miratuar e komponimet joorganike, si dhe qasja e unifikuar në zgjidhjen e detyrave kimike.

Teksti themelor duhet të jetë i plotësuar dhe i përcjellur me:

- ▶ *Eksperimente për demonstrim* ( për shkak të natyrës së eksperimentit e zhvillon arsimtari) dhe *eksperimente* të cilët i zhvillon nxënësi ose grup nxënësish. Për disa eksperimente mund të udhëzohen në burimin prej ku mund të merën. Eksperimenti duhet të përcillet me informata themelore për materialin e nevojshëm dhe mënyrën e realizimit, a sipas nevojës, dhe me fotografim ose skicë. Sidomos duhet të theksohen rreziqet dhe masat e kujdesisë.
- ▶ Udhëzim për realizimin e *aktiviteteve hulumtuese eksperimentale/teorike* për përdorimin e *burimeve të ndryshme të informatave* ( të shkruara dhe elektronike)

është në funksion të verifikimit dhe plotësimit të tekstit themelor dhe lidhshmërinë me përditshmërinë.

- ▶ *Pyetje dhe detyra* të llojit të ndryshëm dhe me shkallë të ndryshme të ndërlikueshmërisë.( gjatë tekstit, sipas tërësive mësimore, teste për lëmi të caktuara mësimore) për verifikimin e përparimit dhe vetëvlerësimit.
- ▶ *Shtojca ilustrative* ( tabela, skema, grafikone, fotografi, ilustrime, harta logjike etj)- të nevojshme, të qarta, të kuptueshme, thjeshtë të numëruara dhe të emëruara me tekst.
- ▶ *Shtojca të shkruara* : gjatë tekstit( tekste plotësuese, zbavitje, për ata të cilët duan ti thellojnë njohurit e veta) dhe në fund të librit( fjalor terminologjik, zgjidhje të detyrave/problemeve, tabela të sistemit periodik etj)

### **Përputhshmëria e librit me moshën e nxënësve**

- ▶ Përmbajtjet e përfshira, zgjedhja e procedurave, modelet që përdoren për prezantimin dhe sqarimin e termeve ose dukurive të caktuara, eksperimentet, materialet, mënyra e prezantimit dhe sqarimit të termeve, niveli shkencor i thellimit (udhëzim në model të caktuar, teori, ligj), zgjedhja e aktiviteteve eksperimentale - hulumtuese, shtojcat ilustrative, pyetje etj, duhet të jenë adekuate me moshën e

nxënësve, faktor themelor për arritjen e njohurive përdoruese, inicimi i motivimit dhe mundësisë për kyçe aktive të nxënësit në procesin e të mësuarit.

### **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv drejt shkencës/ njohurive, zhvillimi i identitetit kombëtar dhe qytetar, multikultura dhe barazia gjinore**

- ▶ Libri duhet të ofroj zgjedhje adekuate të përmbajtjeve, aktiviteteve dhe procedurave që mundësojnë të nxënësi, përveç njohurive të përdorura, të zhvillohen edhe disa shkathtësi) përdorimi i pajisjeve laboratorike, realizimin e tentimeve elementare, kërkimi i burimeve të informatave, përpunimin e të dhënave etj)
- ▶ Përmes aktiviteteve të parapara me librin duhet të zhvillohen edhe shkathtësi të nevojshme në jetën e përditshme( puna në ekip, komunikimi, të menduarit kritik), aftësitë (pedanteria, vërtetësia, ekonomizimi, plotësim, përgjegjësi) raport pozitiv ndaj punës, sjellja me kujdes ndaj materialeve, natyra dhe siguria individuale.



# GJEOGRAFIA

---

## Përputhja e përmbajtjes së librit me programin mësimor

Libri i gjeografisë duhet në mënyrë të drejtë ta interpretojë programin mësimor nga gjeografia për klasën adekuate në arsimimin fillor nëntëvjeçarë (VII-IX), respektivisht për vitin adekuat në mësimin në arsimimin e mesëm (arsimi i gjimnazit dhe shkollimi profesional), edhe atë sipas:

- ▶ qëllimeve mësimore;
- ▶ termeve dhe përmbajtjeve;
- ▶ fondit të orëve;
- ▶ moshës së nxënësve;
- ▶ përkrahjes profesionale, shkencore dhe didaktike-metodike;
- ▶ korrelacioni me lëndët dhe lëmit tjera;
- ▶ standardeve gjuhësore, estetike, artistike dhe grafike.

## Përmbajtja në të arriturat bashkëkohore në lëmin e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës në përdorimin e terminologjisë profesionale.

- ▶ Libri të bazohet në qasjen komparative metodologjike

- ▶ Në libër sidomos duhet të mbahet llogari për mbikëqyrjen, provat, aplikimin e mjeteve mësimore etj.
- ▶ Në fillim të çdo teme dhe përmbajtjeje duhet të ketë lehtë të njohur: fotografi ose hartë, objekt, dukuri, proces etj, që ka të bëjë me vetë temën.
- ▶ Në libër të ketë detyra për inicimin e punës së pavarur të nxënësve të llojit:
  - krahaso karakteristikat;
  - gjej ngjashmëritë dhe dallimet;
  - trego grafikone;
  - zbulo me ndihmën e të dhënave;
  - përpuno diagram sipas të dhënave;
  - nxjerr konkluzion nga faktet;
  - krahasoi të dhënat numerike;
  - përpuno tabelë krahasuese
- ▶ Në libra të ketë elemente për sistematizim të njohurive me përsëritje.
- ▶ Ilustrimet, hartat ose fotografitë të jenë në korrelacion të ngushtë me tekstin.
- ▶ Pyetjet dhe detyrat të jenë të vendosura në mënyrë që do të shkaktojnë zhvillimin e të menduarit kritikë të nxënësit dhe aftësi të analizohen proceset dhe dukurit gjeografike

- ▶ Në libër të mbahet llogari për zhvillimin e të arriturave të njohurive të reja dhe aplikimin e njohurive të fituara më parë ( nga e njohura drejt të panjohurës)
- ▶ Në libër të respektohet parimi i korrelacionit të gjeografisë me lëndët tjera mësimore.
- ▶ Libri të bazohet në fakte të sakta dhe të kontrolluara në përmbajtje.
- ▶ Në përmbajtjet të theksohen jo më shumë se tre ose katër shtojca ose tabela.
- ▶ Libri të jetë i përpunuar ashtu që do ti motivojë nxënësit për punë vetjake ose ekipore për arritje të njohurive të përhershme për proceset dhe dukurit gjeografike.
- ▶ Përmbajtjet nga gjeografia kombëtare të jenë të paraqitura me qasje integrale ndaj rajonit, duke i potencuar elementet e rëndësishme të cilat janë cilësi pozitive të hapësirës kombëtare.
- ▶ Nxënësit të fitojnë njohuri të sakta për hapësirën, historinë e hapësirës me theks të veçantë në të mësuarit e hapësirës së Republikës së Maqedonisë.

## **Përshtatja e librit me moshën e nxënësve**

- ▶ Libri të formalizojë materien mësimore në mënyrë adekuate didaktike të qartë për moshën e nxënësve për të cilët është dedikuar.
- ▶ Në libër të jenë të njohura elementet themelore të cilat nxënësi patjetër duhet ti përvetësojë dhe ndryshojë.
- ▶ Çdo përmbajtje e re të nis me pyetje ose me përkujtim të nxënësve për atë çka është mësuar, e njohur, interesante për nxënësit.
- ▶ Në librat e gjeografisë të mbahet llogari të mos ketë shumë të dhëna faktografike dhe terme të paqarta për nxënësit
- ▶ Në libër duhet të jepen sqarime plotësuese për termet e reja dhe të paqarta.
- ▶ Përmbajtjet në librat e arsimit të gjimnazit dhe arsimit të mesëm profesional të mundësojnë zhvillim të aftësive analitike dhe mendim kritik.

## **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurive, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, multikultura dhe barazia gjinore**

- ▶ Në libra të respektohen ndjenjat nacionale të të gjithë popujve dhe simbolet e të gjitha shteteve të cilat mësohen dhe t'ju shmangemi paraqitjeve stereotipie (racor, etnik , fisnor etj)
- ▶ Në libër të theksohen karakteristikat kryesore të popujve, kombeve, shteteve të caktuara dhe të theksohet rëndësia e kuptimit të ndërsjellë, toleranca dhe bashkëpunimi mes vendeve të regjionit si dhe në nivel global.

INFORMATIKA

---



## **Përputhshmëria e përmbajtjes së librit me programin mësimor**

- ▶ Përmbajtja e librit të mundësoj realizimin e qëllimit dhe detyrave të lëndës dhe të kontribuojë për ti arritur standardet e vendosura në të gjitha nivelet.
- ▶ Libri të përmbaj sasi optimale të informatave për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të lëndës së informatikës dhe sipas madhësisë ti përgjigjet moshës së nxënësve dhe fondit vjetor të orëve.
- ▶ Libri të sigurojë lidhshmëri horizontale dhe vertikale të përmbajtjeve në kuadër të njëjtit ose të lëndëve të ngjashme, gjithkund ku kjo është e mundur.
- ▶ Pasqyra e përmbajtjeve, sistemi i titujve dhe nëntitujve të organizohen sipas parimit të qartë didaktik dhe të siguroj në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë kërkim të përmbajtjeve.
- ▶ Sipas programit mësimor, libri ti përmbaj këto komponenta strukturore: hyrje, pasqyrë të temave dhe përmbajtjeve dhe fjalor të termeve më të rëndësishme. Libri të posedoj strukturë logjike dhe kontinuitet në paraqitjen e përmbajtjeve të programit mësimor, ku çdo pjesë e tekstit ka vendin dhe funksionin e vet.

## **Përmbajtja në të arriturat bashkëkohore në lëmin e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës në përdorimin e terminologjisë profesionale**

- ▶ Përmbajtjet e librit të bazohen në teorinë të vërtetuar shkencërisht, fakte dhe konkluzione.
- ▶ Përmbajtja në libër të paraqitet ashtu që të respektohen parimet themelore metodike dhe metodika e mësimit të lëndës së informatikës.
- ▶ Përmbajtja e librit të bazohet në të arriturat bashkëkohore dhe të dhënat aktuale.
- ▶ Në libër të përdoret sistemi ndërkombëtar i masave dhe njësive.
- ▶ Libri ta nxit dhe përkrah interesin e nxënësve dhe të përmbajë detyra të posaçme të teknologjisë bashkëkohore për nxënësit që janë të talentuar përfushën e informatikës. Libri tu ndihmojë nxënësve të zhvillojnë pavarësi në mësim dhe ti përparoj shkathtësitë në përdorimin e librit.
- ▶ Përmbajtja në libër të paraqitet me fjali të qarta , të padyshimta, kurse shprehjet e huaja të përdoren vetëm kur është e patjetërsueshme.
- ▶ Gjuha të jetë adekuate me lëndën e informatikës dhe terminologjia profesionale të përdoret në mënyrë të rregullt.

- ▶ Libri të ketë strukturë të qartë dhe didaktikisht të jetë mirë e formalizuar. Përmbajtjet ti përmbajnë këto komponenta strukturore: tekst themelore dhe instrument didaktik ( fjali kyçe, shembuj, rezyme, ilustrime, fotografi, skema, grafikone etj).
- ▶ Në fund të tërësisë tematike të gjenden këto komponenta strukturore: integrimi i njohurive, hartë të termeve( terme kyçe dhe relacioni i tyre i ndërsjellë), kahe për burime tjera të njohurive, pyetje dhe detyra për vetëvlerësim të përmbajtjeve të përvetësuara, të formuluar sipas qëllimeve në programin mësimor dhe Taksonomia e Blumit.
- ▶ Libri të jetë në përputhje me mundësitë zhvillimore, aftësitë kognitive dhe paranojohuritë e nxënësit.
- ▶ Libri të tregoj për lidhjet mes termeve në kuadër të temës, lëndës ose lëndëve tjera dhe ti nxit format e ndryshme të të mësuarit në pajtim me natyrën e përmbajtjes.
- ▶ Në libër të ekzistojnë detyra për të menduarit kritik, hulumtim dhe zgjedhje të problemeve.
- ▶ Libri të posedoj elemente të cilat do të mundësojnë nxënësi ta ndjek përparimin e vet në përvetësimin e përmbajtjeve dhe zhvillimin e njohurive dhe të nxit motivim të brendshëm për të mësuar dhe interesim për informatikën.
- ▶ Libri të tregoj për aplikimin e përmbajtjeve dhe ti nxit nxënësit ta përdorin të mësuarën në jetën e përditshme.

- ▶ Libri ti udhëzoj nxënësit në përdorim të burimeve tjera të njohurive dhe ti nxit në zgjerimin dhe thellimin e njohurive.
- ▶ Fjalët e panjohura në libër të jenë qartë të theksuara dhe sqaruara në të njëjtën faqe ku janë përdorur. Përdorimi i ikonave ose fotografive në libër do të kontribuoj për kuptim më të mirë të përmbajtjes.
- ▶ Nëse në libër ekziston material plotësues didaktik, i cili është i dhënë në formë elektronike (CD,DVD etj), është e nevojshme ai të jetë në kontest me përmbajtjet e librit, ti përgjigjet programit mësimor dhe ti përdor përparësitë e atij mediumi në raport me prezantimin e përmbajtjeve dhe të interaktivitetit.

## **Përputhshmëria e librit me moshën e nxënësit**

- ▶ Qartë të theksohet për cilën lëndë, klasë, vit të të mësuarit, lloj të arsimit ose profilit arsimor është i dedikuar libri.
- ▶ Libri ti përmbajë këto komponenta strukturore: hyrje, pasqyrë të temave dhe përmbajtjeve dhe fjalor të termeve më kryesore varësisht nga mosha e nxënësve. Libri të posedoj strukturë logjike dhe kontinuitet në paraqitjen e përmbajtjeve, ku çdo pjesë e tekstit ka vendin dhe funksionin e vet.

- ▶ Numri i termeve të reja kyçe në kuadër të një tërësie funksionale në libër(përmbajtje) të jetë në përputhje me moshën e nxënësit.
- ▶ Shembujt që përmenden në libër duhet të jenë të ndryshëm, në përputhje me moshën dhe në funksion të përmirësimit të paraqitjes dhe kuptimit të përmbajtjes.
- ▶ Detyrat në libër të jenë logjikisht të lidhura me përmbajtjet, qartë të formuluar, precize dhe reale për tu realizuar. Ata të cilat kanë funksione të ndryshme (hyrje në përmbajtje të reja, lidhshmëri, aplikimi, përcaktimi, kontrollimi i njohurive) të jenë të diferencuara sipas ndërlikueshmërisë dhe adekuate me nivelet e ndryshme të njohurit, aftësive dhe shkathtësive të nxënësve.
- ▶ Detyrat në përmbajtje të mos kërkojnë nga nxënësit realizim të aktiviteteve të cilët në çfarëdo mënyre mund ti sjellin në rrezik ose ta rrezikojnë ambientin jetësor dhe ambientin e punës.

**Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurive, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, multikultura dhe barazinë gjinore**

- ▶ Libri të kontribuojë në zhvillimin dhe kultivimin e identitetit nacional dhe kulturor, ta përkrah raportin tolerant ndaj bashkësive tjera etnike dhe fetare dhe në të mos të ketë përmbajtje diskriminuese dhe emra fyes.
- ▶ Në libër të afirmohen parimet për demokracinë dhe të drejtat e njeriut dhe të respektohen barabarësitë gjinore.
- ▶ Në libër qartë të paraqitet raporti etik në aplikimin e teknologjisë informatike.
- ▶ Libri të kontribuoj për formimin e raportit pozitiv ndaj punës, njohurisë dhe ndërtimit të raporteve ndërnjerzore pozitive.

FIZIKĚ

---

## **Përshtatja e përmbajtjeve të librit në programin mësimor**

- ▶ Libri i fizikës duhet të jetë në pajtim me programin mësimor të fizikës për vitin adekuat të mësimimit.
- ▶ Libri të mundësoj arritje të qëllimeve të programit mësimor.
- ▶ Libri si mjet për mësim, studim dhe verifikim duhet të mundësoj prezantim të informatave, termeve, ligjshmërive në funksion të kuptimit të dukurive natyrore nga aspekti i fizikës.

## **Përmbajtja në të arriturat bashkëkohore në lëmin e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës në përdorimin e terminologjisë profesionale**

- ▶ Libri të përmbaj terme, procedura dhe teknika për zgjidhjen e problemeve dhe të mundësoj zhvillim të shkathtësive për hulumtim dhe ta nxit zhvillimin e të menduarit.
- ▶ Libri të jetë në funksion të mësimimit, në arritjen e diturive dhe shkathtësive, në aplikimin e tyre, si dhe në funksion të zhvillimit të kreativitetit të nxënësit.
- ▶ Libri të përkrah mësimin përmes zbulimit, hulumtimit dhe zgjedhjes së problemit.

- ▶ Libri të mundësoj kontrollim dhe vetëvlerësim të të arriturave të nxënësve për çdo temë përmes pyetjeve, aktiviteteve dhe detyrave të asaj teme të tillë që do të mundësojnë kontroll të njohurive të fituara dhe aftësive nga nivele të ndryshme kognitive.
- ▶ Libri të mundësoj nxënësve të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për komunikim, për zgjidhje të problemeve, me çka zhvillohet kuptimi për rrethinën dhe për botën.
- ▶ Përmbajtjet në libër duhet të jenë në korrelacion me lëndët e ngjashme çdo herë kur ekziston mundësi për këtë.
- ▶ Libri ti merë parasysh format e ndryshme të aktiviteteve për fitimin e njohurive dhe shkathtësive për terme të ndryshme në tekstin themelor, ashtu që termet, procedurat dhe proceset të jenë të përpunuara në tërësi të përmbledhura adekuate jo më shumë se dy faqe.
- ▶ Detyrat dhe pyetjet në fund të përmbajtjes mësimore (njësia mësimore) duhet të vendosen sipas nivelit të kërkesave kognitive - prej nivelit të memorimit deri në nivelin e praktikimit të fizikës.
- ▶ Përmbajtjet duhet të jenë të përcjellura me fotografi, ilustrime, grafikone dhe ata duhet të jenë sa më shumë të përfshira dhe të jenë në funksion të përmbajtjes që përpunohet grafikisht.
- ▶ Libri ta përkrah mësimin e të gjitha kategorive të nxënësve (nga nxënës me të arritura më të vogla deri te nxënësit më përparimtar)

- ▶ Libri tu mundësoj nxënësve të fitojnë njohuri individualisht ose në grupe.
- ▶ Libri duhet të ketë aktivitete për nxënësit që duan të dinë më shumë lidhur me ngjarjet nga jeta e përditshme.
- ▶ Në libër të ketë përgjigje dhe zgjidhje të detyrave, të ketë pasqyrë të termeve, të jetë i përcjellur me doracak për mësimdhënësin në të cilin do të tregohet për çdo temë si do të realizohet programi mësimor i fizikës me librin përkatës.
- ▶ Në libër të ketë aktivitetet hulumtuese-eksperimentale dhe udhëzim në përdorimin e burimeve të informatave si të shkruara ashtu edhe elektronike.

### **Përputhshmëria e librit me moshën e nxënësit**

- ▶ Libri të përmbajë aktivitete që i bëjnë më tërheqëse për nxënësit dhe që janë adekuat për moshën e nxënësit.
- ▶ Teksti në libër ( stili, gjerësia e fjalive, terminologjia profesionale) duhet të jetë i kuptueshëm dhe adekuat me interesin dhe nevojat e nxënësve.

### **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurive, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, multikultura dhe barazia gjinore**

- ▶ Libri të mundësoj vetëarsimim të nxënësit dhe krijimin e shprehive për mësim të përjetshëm.
- ▶ Në përmbajtjet duhet të jenë të përfaqësuara multikultura, barazia gjinore dhe toleranca ( në detyra tekstuale eventuale).



# ARSIMI MUZIKOR

---



## Përshtatja e përmbajtjeve të librit në programin mësimor

- ▶ Libri i arsimit muzikor duhet të jetë plotësisht në pajtim me programin mësimor dhe ti përmbaj të gjitha temat programore sipas fondit të paraparë të orëve.
- ▶ Teksti melodik – i notave të jetë i thjeshtë dhe melodik pa shumë kërcime intervale, në pajtim me kërkesat e programeve të klasave me lëvizje logjike intervale - ritmike.
- ▶ Libri duhet ta ndjek programin e arsimit të kulturës/ arsimimit muzikor, duke i ndjekur nevojat individuale të nxënësve të përdorin stile të ndryshme të mësimin të kulturës muzikore.
- ▶ Për realizimin e programit mirë është libri të përcillet me CD të incizuara -audio dhe DVD materiale ku janë përfshirë vepra të kompozitorëve të njohur, vepra muziko-skenike, teknologji të përpunimit të instrumenteve etj. ( në pajtim me temat mësimore të parapara për klasat përkatëse).

## Përmbajtja në të arriturat bashkëkohore në lëmin e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës në përdorimin e terminologjisë profesionale

- ▶ Libri duhet të përmbaj njohuri esenciale, sistemore dhe shkencërisht të vërtetuara nga fusha e arsimit muzikor dhe artit muzikor të shpërndara sipas sistemit paralel-spiral.
- ▶ Të respektohet terminologjia shkencore sipas rregullave dhe të gjithë termet në libër të jenë në bazë shkencore të kuptueshëm për nxënësit, dhe jo terminologji që e krijon autori dhe e njohur vetëm për atë.
- ▶ Përveç teksteve, ilustrimeve dhe pyetjeve në libër duhet të shfrytëzohen edhe resurse tjera të cilët do ta plotësojnë tërësinë didaktike të përmbajtjes, si psh: skema, grafikone, fotografi, rebuse muzikore, fjalëkryqe, periskopi muzikore etj.
- ▶ Tekstet mos të jenë të ngarkuara së tepërmi me të dhëna joesenciale, por duhet të jenë interesante dhe zbavitëse për nxënësit, të nxisin në të menduarit dhe ta motivojnë mësimin.
- ▶ Ilustrimet në libër duhet plotësisht tu përgjigjen përmbajtjeve të tekstit.
- ▶ Në përmbajtjet duhet të jenë të përfaqësuara të gjitha nivelet e njohurive: të mbajturit mend (reproduktimi i thjeshtë) të kuptuarit (kuptimi) dhe nivelet më të larta të diturive ( zbatimi, analiza, sinteza).
- ▶ Gjatë përpunimit të librit përmes përmbajtjeve të tij duhet të vendoset integrim me lëndët tjera mësimore.

- ▶ Një nga pikënisjet e librit duhet të jetë arti muzikor botëror, si dhe kultura muzikore dhe arti në Republikën e Maqedonisë nga e kaluara deri sot.
- ▶ Përmes temave, përmbajtjeve dhe aktivitete të parapara me programin mësimore, nxënësit të kenë mundësi ti shprehin afinitetet e tyre në fushën e artit muzikor dhe kulturës, ti zgjerojnë dhe thellojnë njohurit për fushat për të cilat kanë interes të veçantë, si dhe për muzikë aktive (këndim dhe luajtje në instrumente) përmes shprehjes së stileve individuale dhe parapëlqimeve të zhanreve.
- ▶ Arti muzikor të jetë i paraqitur në mënyrë të barabartë me të jetuarit kulturor, shoqëror, ekonomik dhe historik të përditshmërisë.
- ▶ Pyetjet dhe detyrat duhet të jenë të formuluar në mënyrë që të nxit mendim kritik dhe të hapur, si dhe aftësi për nxitje të pavarësisë dhe kreativitetit të nxënësve, kuptimin për punë ekipore, përgjegjësinë, aftësi për të planifikuar dhe të zhvillohet aktivitet i caktuar nga fillimi deri në fund.
- ▶ Duhet të mbahet llogari në përfaqësimin e të gjithë periudhave të historisë së muzikës, nga krijimi deri më sot, pa dhënë ndonjë rëndësi më të madhe ose më të vogël të disa periudhave historike muzikore.
- ▶ Kur paraqitet biografia e kompozitorit, patjetër të ketë fotografi të tij dhe të mbahet llogari për informatat e rëndësishme të jetës dhe veprës së kompozitorit, të kuptueshme për nxënësin. Nëse ka ngjarje interesante dhe anekdota për kompozitorin ose, tregim interesant të paraqitet që të shmanget ofrimi i vetëm të dhënave fotografike ( sidomos në librin për arsim fillor)
- ▶ Detyrat për veprat që dëgjohen të jenë në mënyrë precize dhe të qartë të parashtruara dhe tu përgjigjen termeve dhe përmbajtjeve mësimore.
- ▶ Këngët që mësohen duhet të jenë më së shumti me dy strofa me ose pa refren, më së shumti me tre strofa në klasat më të larta.
- ▶ Te veprat për dëgjim të muzikës, në libër mund të jepet fragment i shkurt dhe karakteristik të veprës që është lehtë i njohur ose nxënësit të mund ta këndojnë ose luajnë.
- ▶ Tema mësimore *Instrumentet muzikore* duhet të jetë e përkrahur me audio ose video incizim ku theksohet instrumenti që përpunohet ose është e përcaktuar vepra për dëgjim në programin mësimore ( detyrat për njohjen e instrumentit të cilat do të jepen në libër duhet të udhëzohen në identifikimin vizual dhe audio të instrumentit, ose përcaktimin e dallimeve dhe ngjashmërive mes instrumenteve)
- ▶ Për veprat muziko-skenike autorët përveç tekstit duhet të përdorin edhe fotografi nga akteve të ndryshme të veprës, me çka nxënësit do të fitojnë pasqyrë më të qartë për veprat muziko-skenike.

- ▶ Në nivelet më të larta të arsimit (arsimi i mesëm) përmbajtjet e arsimit muzikë duhet të jenë më vëllimore, më përmbajtjesore, ta thellojnë njohurin e nxënësit dhe të krijojnë mundësi për hulumtim dhe për diskutime për tema të caktuara. Pjesa ilustrative të jetë më e pasur, e qartë dhe në lidhje me temat mësimore adekuate dhe të vendoset theksi në veprimtarin muzikore vendore, si dhe të zhanreve muzikore popullore. Në këto libra gjithashtu, duhet të jenë të përfaqësuar të gjithë elementet përcjellëse që janë përmendur më lartë në tekst.
- ▶ Në fund në libër mund të ketë edhe interpretues për sqarimin e termeve të panjohura.

## **Përputhshmëria e librit me moshën e nxënësit**

- ▶ Pyetjet dhe detyrat në libër të mos jenë me dy kuptime, por precize dhe konkrete që do të përgjigjen me përmbajtjen e tekstit. Ata duhet ti përgjigjen moshës së nxënësve, ta motivojnë kreativitetin e tyre dhe ta zhvillojnë zhvillimin psikofizik dhe vlerat estetike të nxënësit.
- ▶ Të gjitha tekstet në libër të jenë të kuptueshme dhe me gjuhë dhe stil që përgjigjet në moshën e nxënësve.
- ▶ Fjalitë në libër të jenë më të ndërlikuara nga fjalitë që i përdorin nxënësit, që të mund libri ta nxit zhvillimin e

gjuhës në shprehjen e nxënësve, ashtu që fjalitë mos ta rëndojnë kuptimin e materialit.

- ▶ Shembujt nga literatura muzikore dhe këngët me shënim notor të jenë të adaptuara në aftësitë vokale të moshës së caktuar të nxënësve.
- ▶ Paraqitja e shkallëve të jetë qartë e sqaruar dhe patjetër të vijojnë ushtrime të shkurta melodike në shkallën adekuate (të adaptuara me kërkesat e temës Shkrimi muzikor), si dhe të mbahet llogari për aftësitë vokale të moshës së caktuar të nxënësve.
- ▶ Instrumentet muzikore për fëmijë duhet të aplikohen varësisht nga moshja e nxënësve (së pari ritmik e pastaj melodik)
- ▶ Ushtrimet që do të realizohen me instrumentet muzikore për fëmijë duhet të përgjigjen në moshën e nxënësve (nga vlerat notare më të lehta deri te më të rëndat).

## Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurive, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, multikulturës dhe barazisë gjinore

- ▶ Nxënësit nuk duhet të fitojnë vetëm njohuri dhe përvoja nga arti muzikor të cilat do të mund të gjejnë aplikim në arsim, por edhe në jetën e përditshme, duke mundësuar jetë më kualitative, plotësimin e kohës së lirë, aftësi për ta gjetur veten në mjedisin muzikor dhe kulturor të rrethinës së afërt, qytetit dhe më gjerë.
- ▶ Kultura dhe tradita e të gjithë bashkësive etnike/ kulturore në Republikën e Maqedonisë duhet të paraqiten si kulturë dhe traditë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, në prizmin e rëndësisë së saj për Republikën e Maqedonisë si mjedis multikulturor/multietnik.
- ▶ Në libër duhet të përfaqësohen edhe autor të rëndësishëm për kulturën/traditën në Republikën e Maqedonisë, duke i kyçur autoritete (edhe meshkuj edhe femra) të cilët u takojnë bashkësive të ndryshme etnike/kulturore që jetojnë në Republikën e Maqedonisë
- ▶ Kur mendohet në veprimtarin popullore në Republikën e Maqedonisë (muzikë popullore, valle popullore, veshje tradicionale) duhet të kyçet edhe veprimtaria

popullore e bashkësive të ndryshme etnike/kulturore që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.

- ▶ Libri - përveç që duhet të jep informata themelore nga fusha e kulturës muzikore, ai patjetër duhet të paraqes edhe promovimin e tolerancës, bashkëpunimin dhe raportet kooperative në mes nxënësve të bashkësive të ndryshme etnike.
- ▶ Nxënësit të fitojnë njohuri për vlerat e përgjithshme artistik-civilizuese dhe muzikor -folklorike ne botë dhe te ne dhe ta thellojë interesin për mësim të mëtutjeshëm të ngjarjeve dhe proceseve muzikore.



ARSIMI  
FIGURATIV

---

## **Përputhshmëria e përmbajtjes së librit me programin mësimor**

- ▶ Libri duhet të jetë plotësisht në përputhje me programin mësimor dhe ti përmbaj të gjitha temat programore ( fushat artistike)
- ▶ Njësit metodike në libër të jenë të shpërndara në kontiunitet në përputhje me nevojat dhe kërkesat e programit.
- ▶ Libri duhet të përmbaj njohuri esenciale të sistematizuara dhe shkencërisht të verifikuara të shpërndara nëpër sistemin paralel-spiral të vlerave artistike nga e kaluara deri sot.
- ▶ Përmes temave, përmbajtjeve dhe aktiviteteve të parapara me programin mësimor nxënësit të kenë mundësi ti shprehin afinitetet e tyre dhe aftësitë individuale në fushën e artit dhe kulturës figurative, ti zgjerojnë dhe thellojnë njohurit për fushat artistike për të cilat kanë interes të posaçëm, si dhe për krijimin artistik aktiv (vizatim, fotografim) përmes shprehjes së paranjohurive individuale.

## **Përmbajtja në të arriturat bashkëkohore në lëmin e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës në përdorimin e terminologjisë profesionale**

- ▶ Nxënësit të fitojnë njohuri të përgjithshme për vlerat artistike-civilizuese dhe artistike-estetike në botë dhe te ne dhe ta thellojnë interesin për mësim të mëtutjeshëm të ngjarjeve dhe proceseve artistike.
- ▶ Përvetësimi i elementeve dhe parimeve figurative të vendoset në formë të radhëve koncentrik përmes tërë procesit arsimor.
- ▶ Të respektohen rregullat e terminologjisë shkencore dhe të gjitha termet në libër të jenë në bazë shkencore të kuptueshëm për popullatën më të gjerë artistike dhe nxënësit, dhe jo terminologji të cilën e ka krijuar autori dhe është e njohur vetëm për atë.
- ▶ Të respektohet relacioni mes teksteve, ilustrimeve dhe detyrave për nxënësit.
- ▶ Në libër të dominojnë ilustrimet dhe në tërësi ti përgjigjen përmbajtjes së tekstit.
- ▶ Përveç teksteve, ilustrimeve dhe pyetjeve, në libër duhet të përdoren edhe resurse tjera të cilët do ta plotësojnë tërësinë didaktike të përmbajtjes , si psh. skema, grafikone, fotografi, riprodhime të veprave artistike të autorëve artistik të njohur të vendit dhe të huaj.
- ▶ Gjatë përpunimit të librit, autorët duhet përmes përmbajtjeve të vendosin integrim me lëndët tjera.
- ▶ Pikënisje në libër duhet të jetë arti figurativ botëror, si dhe kultura dhe arti figurativ në hapësirat tona nga e kaluara deri sot.

- ▶ Pyetjet dhe detyrat duhet të jenë të formuluar në mënyrë që do të nxisin mendimin kritik dhe të hapur, si dhe aftësi për nxitje të pavarësisë dhe kreativitetit të nxënësve, kuptimi për punë ekipore, përgjegjësi, aftësi për planifikim dhe të zhvillohet ndonjë aktivitet figurativ nga fillimi deri në fund.
- ▶ Duhet të mbahet llogari për përfaqësimin e të gjitha periudhave të historisë së artit figurativ, nga paraqitja deri sot, pa i dhënë ndonjë vëmendje më të madhe ose më të vogël ndonjë periudhe të caktuar historike.
- ▶ Në përmbajtjet duhet të jenë të përfaqësuara të gjitha nivelet e njohurive: të mbajturit mend (riprodhimi i thjeshtë), të kuptuarit (kuptimi) dhe nivelet më të larta të njohurive (aplikimi, analiza estetike, sinteza).
- ▶ Kur paraqitet riprodhimi i artistit figurativ patjetër të ketë biografi të shkurtër për atë dhe të mbahet llogari për informatat kryesore për jetën dhe veprën e artistit. Nëse ka ngjarje interesante dhe anekdota për artistin figurativ, ose ndonjë tregim interesant të lidhur për veprën që shihet, është mirë të përdoret.
- ▶ Riprodhimi i veprave artistike të cilat janë paraqitur duhet të mbrohen dhe qartë të vendosura, tu përgjigjen termeve dhe programit mësimor.
- ▶ Në fund të librit duhet të parashihet fjalor i fjalëve të panjohura dhe termeve të terminologjisë artistike, që të mund nxënësi të shërbehet me gjuhën artistike në komunikimin e përditshëm.

## Përputhshmëria e librit me moshën e nxënësit

- ▶ Të gjitha tekstet në libër të jenë në mënyrë të rregull të dozuara, të kuptueshme dhe me gjuhë dhe stil që përgjigjet për moshën e nxënësve.
- ▶ Madhësia e teksteve dhe të dhënave të jenë adekuat për moshën e nxënësve, kurse fjalitë në libër të mundësojnë zhvillim të gjuhës dhe shprehjes së nxënësve.
- ▶ Tekstet të jenë të shkurta dhe të mos jenë të ngarkuar me të dhëna të panevojshme dhe joesenciale dhe të jenë të kuptueshëm për nxënësit.
- ▶ Tekstet dhe ilustrimet në libër të mos jenë me dy kuptime dhe të jenë precize dhe konkrete ashtu që ti përgjigjen përmbajtjes së tekstit. Ata duhet ti përgjigjen moshës së nxënësve, ta motivojnë kreativitetin e tyre dhe ti zhvillojnë vlerat artistike-estetike, vlerat individuale dhe zhvillimin psikofizik të nxënësve.

**Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurive, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, multikultura dhe barazia gjinore.**



- ▶ Tekstet të përmbajnë porosi edukative dhe pozitive, kurse të jenë në funksion të sqarimit të problemeve artistike.
- ▶ Kultura dhe tradita e të gjitha bashkësive etnike/kulturore në Republikën e Maqedonisë duhet të paraqitet si kulturë dhe traditë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë si mjedis multikulturor/multietnik.
- ▶ Në libër duhet të jenë të përfaqësuar edhe autor të rëndësishëm për kulturën/traditën në Republikën e Maqedonisë, duke kyçur autor ( edhe meshkuj edhe femra) pjesëtar të bashkësive etnike/kulturore që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.
- ▶ Kur mendohet për krijimtarinë popullore të Republikës së Maqedonisë (filigranit, artizanatit, sharat dhe ngjyrat në veshjet tradicionale) duhet të kyçet edhe krijimtaria popullore e bashkësive të ndryshme etnike/kulturore që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.
- ▶ Libri, përveç që duhet të ofroj informata themelore nga fusha e kulturës artistike, patjetër duhet të paraqes edhe promovim të tolerancës, bashkëpunimit dhe raportit kooperues mes nxënësve të bashkësive të ndryshme etnike.

# GJUHËT KLASIKE (GJUHA LATINE /GJUHA E VJETËR GREKE)

---

## **Përputhshmëria e përmbajtjes së librit me programin mësimor**

- ▶ Libri i gjuhëve klasike ( libri i gjuhës latine ose gjuhës së vjetër greke) del nga plani mësimor dhe programi mësimor i gjuhës latine.

## **Përmbajtja në të arriturat bashkëkohore në lëmin e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës në përdorimin e terminologjisë profesionale**

- ▶ Libri duhet të mundësoj përvetësim të njohurive esenciale, të sistematizuara dhe aplikative nga fusha e gjuhës latine dhe civilizimit dhe kulturës klasike romake, respektivisht gjuhës së vjetër greke dhe civilizimit dhe kulturës klasike helene.
- ▶ Libri duhet të jetë i strukturuar në mënyrë që të nxënësit të nxit interes për thellim të mëtutjeshëm të mësimit të gjuhëve klasike dhe letërsisë, historisë dhe kulturës.
- ▶ Përmbajtjet në libër duhet të jenë të strukturuar në mënyrë që ti mundësojnë arsimtarit lëndor vet dhe në mënyrë kreative ti kombinojë komponentët e ndryshme sipas interesit të nxënësve.

- ▶ Të respektohet relacioni adekuat mes teksteve, materialit gramatikor, ilustrimeve dhe detyrave ose ushtrimeve për nxënësit.
- ▶ Përmbajtjet në libër të jenë të organizuara qartë, me strukturë të qartë të komponentave të caktuara dhe me dizajn grafik modern, estetikisht tërheqëse për moshën e caktuar të nxënësit.
- ▶ Të insistohet me zgjidhje grafike adekuate ( theksuar me ngjyra, nënvizim, barabarësi, ngushtim ose zgjerim të rreshtave) vizuelisht të sugjerohet cilët pjesë të tekstit janë më të rëndësishme, cilat informata janë në mënyrë plotësuese të sqaruara ose paraqesin udhëzime për punën e nxënësve.
- ▶ Detyrat dhe pyetjet duhet të jenë të formuluar në mënyrë që do të nxit mendim kritik dhe aftësi për krahasim, analiza dhe sinteza)
- ▶ Tekstet, shembujt dhe detyrat duhet të mundësojnë mënyrë interaktive të punës.
- ▶ Zgjedhja e përmbajtjeve duhet të mundësoj fitim të niveleve dhe llojeve të ndryshme të njohurive: të mbajturit mend (riprodhimi i thjeshtë), të kuptuarit (kuptimi) dhe nivelet më të larta të njohjes ( zbatimi, analiza, sinteza).
- ▶ Përmbajtje në libër duhet të jenë në korrelacion me lëndët tjera mësimore të ngjashme çdoherë kur ka mundësi për këtë

- ▶ Rekomandohet që drejtpërdrejt përkrah çdo përmbajtje në të cilën ka tekst ose fjali në gjuhën latine ( gjuhën e vjetër greke) të vendoset edhe fjalor i vogël me kuptimin e fjalive që hasen për herë të parë në libër.
- ▶ Si përmbajtjet plotësuese duhet të vendoset fjalor latine - maqedonas ( nëse ka nevojë edhe maqedone-latin)( respektivisht fjalor i të gjuhës së vjetër greke - maqedonishtë) në të cilin do të përfshihet leksiku i tërësishëm e përfaqësuar në tekstet, fjalitë, shembujt dhe ushtrimet për nxënësit.
- ▶ Materiali didaktik që duhet ta përcjell çdo libër gjatë përpunimit të përmbajtjeve mund të përmbajë: pyetje, detyra, fotografi, ilustrime, grafikone, harta historike, tabela kronologjike dhe ata duhet të jenë sa është e mundur më shumë të përfaqësuar në pajtim me përmbajtjen që përpunohet.
- ▶ Libri patjetër duhet të përmbaj edhe sqarime të shkurtesave që përdoren në të.
- ▶ Përmbajtjet dhe materialet didaktike duhet ti motivojnë nxënësit në punë të pavarur, hulumtime dhe diskutime.

## **Përputhshmëria e librit me moshën e nxënësit**

- ▶ Përmbajtjet e përfaqësuar në libër duhet të jenë të paraqitura me gjuhë dhe stil adekuat me moshën e nxënësve të cilëve u dedikohet, me të cilët njëkohësishtë pozitivisht do të ndikohet në kulturën e tyre të shprehjes së gjuhës amtare.
- ▶ Në çdo përmbajtje duhet të ofrohet sqarim të termeve të reja sipas moshës së nxënësve.

## **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurive, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, multikulturën dhe barazinë gjinore.**

- ▶ Të insistohet në tekste, me zgjedhjen e shembujve dhe sidomos, me detyrat dhe ushtrimet tu sugjerohet nxënësve rëndësinë dhe aplikimin e gjuhës latine( respektivisht gjuhës së vjetër greke) në segmentet e ndryshme të jetës bashkëkohore.



# PSIKOLOGJIA

---

## **Përputhshmëria e përmbajtjes së librit me programin mësimor**

- ▶ Libri i psikologjisë del nga plani mësimor dhe programi mësimor i psikologjisë.
- ▶ Libri duhet t'u mundësoj nxënësve që ti përvetësojnë njohurit esenciale dhe të sistematizuara për dukuritë psikologjike përmes përmbajtjeve me të cilat do të arrihen qëllimet e definuar me programin mësimor.
- ▶ Libri të sigurojë prezencë të të gjitha temave mësimore të parapara me programin mësimor, sipas renditjes logjike të materialit mësimor dhe në pajtim me fondin e orëve mësimor, si dhe të programit, respektivisht profilit të arsimit për të cilin është dedikuar libri.
- ▶ Përmbajtjet në libër të tregojnë për ndërlikueshmërin e jetës psikike të njeriut dhe bashkimin e ndërsjellë të tre grupeve dukurive psikike: proceset psikike (intelektuale, emocionale dhe motivuese), gjendjet psikike (vëmendja, lodhja..) dhe karakteristikat psikike (temperamenti, karakteri, aftësitë, qëndrimet).
- ▶ Pikënisje kryesore të jetë individi dhe dallimet individuale në intensitetin dhe cilësitë e dukurive psikike te njerëzit.
- ▶ Në përputhje me programin mësimor, detyrat, ilustrimet dhe çështjet janë paraqitur duhet të mundësojnë mënyrë interaktive në punë dhe të njëjtat të udhëzojnë nxënësin në mënyrën problematike dhe të të mësuarit.

- ▶ Përmbajtjet në libër duhet të jenë në korrelacion me lëndët e ngjashme mësimore çdo herë kur për atë ekziston mundësia.
- ▶ Përmbajtjet të jenë të mbështetura me shembuj nga hulumtimet psikologjike relevante dhe të udhëzojnë burime plotësuese të njohurive për temat që përfshihen në program.

## **Përmbajtja në të arriturat bashkëkohore në lëmin e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës në përdorimin e terminologjisë profesionale.**

- ▶ Përmbajtjet të kenë bazueshmëri shkencore dhe të bazohen në të arriturat më të reja psikologjike.
- ▶ Si pasqyrë dhe mënyrë të qartë të paraqiten metodat dhe teknikat themelore të cilat do të shfrytëzohen në psikologjinë shkencore, të cilat përqendrohen në hulumtimin bashkëkohor të psikologjisë.
- ▶ Libri të ketë strukturë të qartë dhe pasqyrë dhe ti përcjell parimet didaktike.
- ▶ Përmbajtjet të jenë të qarta për nxënësit, të përcillen me fotografi, ilustrime, piktura, grafikone, të cilat janë në funksion të përmbajtjes e cila përpilohet në përputhje me moshën e nxënësit.

- ▶ Detyrat dhe pyetjet duhet të radhiten sipas niveleve të kërkesave kognitive dhe ashtu të konceptohen, që do ta udhëzojnë nxënësin në përmbajtje të re.
- ▶ Në përmbajtje duhet të përfshihen të gjitha nivelet e njohurive: të mbajturit mend ( riprodhimi i thjeshtë) kuptimi ( të kuptuarit dhe nivelet më të larta të njohurive ( zbatimi, analiza dhe sinteza).
- ▶ Pyetjet dhe detyrat e nxënësve duhet të formohen në atë mënyrë që do të nxit mendim dhe zhvillim kritik të aftësive analitike dhe kritike te nxënësve.
- ▶ Libri i psikologjisë duhet të ofrojë më tepër argumente për pyetjet e hapura të cilat nxisin diskutim dhe zhvillim të të menduarit divergjent.
- ▶ Përmbajtjet duhet ti thellojnë njohuritë e nxënësve dhe të krijojnë mundësi për aktivitet hulumtues te nxënësit.
- ▶ Libri i psikologjisë duhet të ofrojë material mësimor (tekste profesionale dhe informative) për të menduarit dhe përmbylljen e pavarur për proceset dhe dukurit psikike.
- ▶ Përmbajtjet ti përpilojnë proceset kognitive ( të mësuarit, të mbajturit mend, të menduarit) në mënyrë që do ti mundësojë nxënësit lidhshmëri me përvojën e përditshme dhe zbatimin praktik në procesin e të mësuarit.
- ▶ Libri duhet tu mundësoj nxënësve të arrijnë njohuri për karakteristikat zhvillimore dhe personalitetin e

njeriut dhe të njëjtat ti zbatojë praktikisht në njohjen e vetvetes dhe tjerët në përditshmëri.

- ▶ Nxënësit të mund të njihen me terminologjinë themelore psikologjike dhe ta shfrytëzojnë drejtë.
- ▶ Në fund të librit duhet të ketë fjalor psikologjikë.

## **Përshtatja e librit me moshën e nxënësve**

- ▶ Libri sipas vëllimit duhet ti përshtatet moshës së nxënësit dhe ti përcjell karakteristikat zhvillimore të tij.
- ▶ Stili dhe gjuha me të cilën është shkruar libri duhet të jetë e qartë, i padyshimtë dhe i kuptueshëm- adekuat me moshën e nxënësve për të cilët dedikohet.
- ▶ Madhësia e teksteve dhe numri i të dhënave të jenë në përputhje me moshën e nxënësve.
- ▶ Fjalitë nuk duhet të jenë shumë të gjata dhe ta vështirësojnë kuptimin e materialit.
- ▶ Mësimi i psikologjisë duhet të jetë argëtues dhe të nxis kureshtje dhe interesim.



## **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurive, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, barazinë gjinore dhe multikulturore.**

- ▶ Libri duhet t'i nxit nxënësit të kenë kujdes për shëndetin mental të vetin dhe njerëzve tjerë.
- ▶ Libri t'ju mundësoj nxënësve që ti kuptojnë dhe interpretojnë përjetimet e tyre dhe përvojat në përputhje me njohurit shkencore psikologjike dhe të krijojnë fotografimin për vetveten.
- ▶ Shfrytëzimin e mekanizmave mbrojtës që të mundet nxënësit në mënyrë konstruktive të ballafaqohen me problemet që i hasin në mjedisin e përditshëm.
- ▶ Libri duhet ti motivoj nxënësit ta nxis procesin e të mësuarit dhe të krijojë kushte për zhvillimin e hapur dhe të menduarit tolerues.
- ▶ Libri duhet të ofroj përfshirje adekuate të përmbajtjeve për aspektet socio-kulturore të sjelljes së njeriut me qëllim që të kontribuojë në formimin e sistemit pozitiv të vlerave dhe në zhvillimin e shkathtësive sociale.
- ▶ Libri duhet të mundësojë mirëkuptim dhe respekt, dallimeve në mes njerëzve sa i përket përkatësisë së tyre etnike, gjinore, socio-ekonomike, religjioze, moshës etj.

- ▶ Përmbajtjet në libër duhet të mundësojnë kuptim dhe zbatim të parimeve etnike në psikologji.

LIBRAT NË LËNDËT  
PROFESIONALE NË ARSIMIN  
E MESËM PROFESIONAL

---

Në arsimin e mesëm profesional vend të rëndësishëm kanë lëndët mësimore që janë në funksion në profesionin e dhënë, gjegjësisht në profilin për të cilin janë përcaktuar nxënësit. Në atë drejtim orientohen drejtimet e përgjithshme (pavarësisht drejtimin gjegjësisht profilin) që duhet t'i përmbushin gjatë përpilimit dhe vlerësimit të teksteve shkollore për lëndët profesionale.

Gjatë definimit të kriterëve për përpilimin e librave për arsimin e mesëm profesional janë shfrytëzuar përvojat e pedagogjisë tonë të deritanishme praktike dhe teorike, arritjet e disiplinave shkencore ( didaktika, psikologjia), shkenca për gjuhën etj, të ndërlidhura me vendin dhe rolin e librit në procesin edukativë – arsimor, si dhe përvojat e vendeve tjera.

Me kriteret për përpilimin e librave nga lëndët profesionale, në arsimin e mesëm profesional krijohet bazë e cila mundëson dhënie të udhëzimeve për autorët e ardhshëm të librave se si t'i përmbushin kërkesat e parapara në mënyrë më të përshtatshme.

Kriteret për lëndët profesionale i theksojnë nevojat e:

- ▶ interaksionit më të madhe ndërmjet përmbajtjeve të librit dhe nxënësit;
- ▶ zhvillimit të shkathtësive dhe kompetencave që dalin nga profili arsimor
- ▶ fleksibilitetit më të madh dhe mundësi për plotësimin dhe zgjerimin e përmbajtjeve ekzistuese me përmbajtjet e reja të librit të cilat i përcjellin të

arriturat më të reja në lëmi të caktuara profesionale;

- ▶ përdorimit të përmbajtjeve të librit në formë elektronike;
- ▶ plotësimin të përmbajtjeve të librit me mjete mbikëqyrëse dhe mjete tjera shkollore;
- ▶ realizimit të një pjese të përmbajtjeve të librit në bashkëpunim me partner socialë.

## **Përmbajtja ndaj të arriturave bashkëkohore në lëmin e caktuar shkencore, metodologjinë e studimit të lëndëve dhe përdorimi i terminologjisë profesionale**

- ▶ Përmbajtja e librave bazohet në teoritë e kontrolluara shkencore dhe të përgjithshme të pranueshme në shkencë
- ▶ Përmbajtja e librave bazohet në faktet shkencore të përfshira në përgjithësi dhe interpretimi i dukurive dhe proceseve.
- ▶ Nëse në libra shpjegohen paragjykime të paverifikuara, ata në përmbajtje të librave theksohen qartë në mënyrë adekuate.
- ▶ Librat bazohen në teoritë e vërtetuara shkencore të cilat nxënësi mund ti kuptoj plotësisht, ndërsa zbatimi praktik i tillë në shkolla ka të bëjë me shkallën e

zhvillimit psikofizik të nxënësve, me çka nuk e dëmton zhvillimin e tyre natyror fizik dhe psikik.

- ▶ Librat bazohen në teoritë shkencore të cilat janë në përputhje me parimet etike.
- ▶ Librat u përshtaten aftësive të njohurive, paranjohurive dhe interesave të nxënësve.
- ▶ Librat nxisin në mësimin me kuptim në lëmit e tyre mësimore, udhëzojnë në zbatimin e strategjive të ndryshme të të mësuarit dhe në zhvillimin e mendimit kritik.
- ▶ Librat na udhëzojnë në vërejtjen e nocioneve dhe fakteve të rëndësishme, në vendosjen e çështjeve kritike, kërkimin e informatave, verifikimi i paragjykimeve, zbatimi i njohurive dhe shkathtësive gjatë zgjidhjes së problemeve etj.
- ▶ Librat i nxisin në interes për lëndët mësimore dhe në qëndrimet pozitive ndaj përmbajtjes të lëndëve mësimore .
- ▶ Librat nxisin në motivimin e brendshëm për mësim.
- ▶ Librat zhvillojnë lidhje të pandërprera ndërmjet nocioneve në kuadër të lëndëve mësimore dhe orientojnë në lidhshmërinë e nocioneve në lëndët e ngjashme mësimore.
- ▶ Librat janë mjete nxitëse për mësimin, studimin dhe hulumtimin e pavarur.
- ▶ Numri i nocioneve të cilat aplikohen gjatë përpilimit të përmbajtjeve të reja është i kufizuar, që nënkupton se

gjatë përpilimit të njësive të reja mësimore aplikohen më së shumti deri në dhjetë nocione të reja kyçe varësisht prej moshës së nxënësve gjegjësisht prej mundësive të njohurive të nxënësve.

- ▶ Librat përfshijnë tërësi tematike prej një ose më tepër programe të ngjashme mësimore (varësisht prej llojit të librit).
- ▶ Librat detyrimisht i përcjellin qëllimet dhe detyrat e programeve mësimore për lëndët profesionale adekuate. Në libra vërehet qartë se çka duhet nxënësit të mësojnë , sa të mësojnë, si ta bëjnë atë, me ndihmën e cilave mjete ta bëjnë, dhe në cilat vende dhe në cilat situata mund ti kontrollojnë njohurit e përvetësuara dhe të njëjtën ku mund ta zbatojnë.
- ▶ Librat janë të strukturuar në përputhje me njohurit dhe metodologjinë e shkencave amë, strategjitë aktuale didaktike dhe kërkesat e metodikës në lëndën mësimore.
- ▶ Librat përmbajnë instrumente metodike që bazohen në shkencën amë të lëndës mësimore dhe në hapat themelore psikologjike-didaktike gjegjësisht elementet: motivimi, përgatitja, përvetësimi, përsëritja, ushtrimet , sistematizimi, zbatimi dhe kontrollimi i njohurive.
- ▶ Librat e përkrahin mësimin e hapur ( me përvojë, të kthyer ka nxënësit, projektues, problematik, komunikues, human etj.) dhe nxisin në përhapjen dhe thellimin e njohurive.

- ▶ Gjatë vendosjes së përmbajtjeve nëpër libra shfrytëzohen shtojca figurative, grafike, skematike, tabelore etj.
- ▶ Termet profesionale në libra janë në nivel të mundësive të njohurive të nxënësve dhe sqarohen në mënyrë të kuptueshme.
- ▶ Librat i respektojnë dallimet ekzistuese ndërmjet nxënësve, kështu që ofrojnë përmbajtje të dy deri në tre nivele të njohurive duke i diferencuar paraprakisht sipas shkalles së kërkesave.
- ▶ Deri në 30% nga përmbajtjet e reja në libra janë parashtruar në mënyrë që mundëson nxënësve të mësojnë në mënyrë të pavarur.
- ▶ Në fillim të secilës temë në libra theksohen termet e reja për të cilët do të mësojnë.
- ▶ Librat sipas rregullës përmbajnë parathënie nga i cili nxënësit mund të shohin qart çka dhe si mundet të mësojnë, përmbyllje të shkurta për temat dhe në fund lista e nocioneve.
- ▶ Ilustrimet dhe radhitja tekniko-grafike në libra sipas përmbajtjes janë në përputhje me tekstin dhe kontribuojnë për të kuptuarit e tekstit dhe për motivimin e përdorimit të librave.
- ▶ Ilustrimet në libra kanë funksionin e tyre, i përshtaten moshës së nxënësve dhe përshkruhen me numra, me titull dhe tekst që i sqarojnë.

- ▶ Librat përmbajnë ilustrime dhe mjete të shprehura grafike në paraqitjen dhe sqarimin e përmbajtjes dhe promovimin e vlerave estetike.
- ▶ Librat shkruhen në gjuhën standarde, në përputhje me drejtshkrimet e lejuara ( maqedone, shqipe, turke.)
- ▶ Tekstet në libra janë të pasqyruara dhe të shkruara ashtu që të mundësojnë përvetësimin e pavarur të karakteristikave gjuhësore dhe shërbim të pavarur me gjuhën standarde në komunikimin gojor dhe me shkrim.
- ▶ Librat vëmendje të posaçme i kushtojnë pasurimit të vazhdueshëm të fjalorit të nxënësve.
- ▶ Tekstet, veçanërisht shembujt janë të përshtatshme për paranjohuritë dhe aftësitë psikofizike të nxënësve, moshës së tyre dhe botës që i rrethon në përputhje me njohurit e psikolinguistike.
- ▶ Në libra u shmangen fjalëve të panevojshme të huaja dhe internacionalizmave.
- ▶ Në libra u shmangen definicioneve negative, pyetjeve të parashtruara negative.
- ▶ Përmbajtja e librave formohet në mënyrë afirmative në përputhje me rekomandimet e UNESCO- os (veçanërisht ato përmbajtje që kanë të bëjnë me vende tjera dhe njerëz tjerë).
- ▶ Në libra përdoren shkurtesa, simbole dhe shenja të nominuara në gjuhën standarde maqedonishte.

- ▶ Në libra përdoren njësi të shënuara matëse dhe shkurtesat e tyre në përputhje me standardet maqedonase.
- ▶ Titujt që meren nga vendet e huaja për të cilat nuk ekziston titull maqedonas dhe të cilat nuk janë të nominuara sipas drejtshkrimit, merren në formë siç është e pranuar në strukturë.

### **Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/ njohurive, zhvillimin e identiti kombëtar dhe qytetar, multikultura dhe barazia gjinore**

- ▶ Librat bazohen në të vërtetën , kontrollin dhe objektivitetin e përmbajtjeve, drejtat e përgjithshme të njeriut dhe parimet e demokracisë.
- ▶ Librat na udhëzojnë në anën morale dhe për pasojat e zhvillimit shkencor dhe teknologjikë
- ▶ Librat bazohen në praninë e kushteve të përgjithshme të krijimit , zhvillimit të njeriut dhe rruajtjen e natyrës.
- ▶ Librat zhvillojnë lidhshmëri ndaj parimeve të demokracisë dhe sundimin e së drejtës.
- ▶ Librat kundërshtojnë angazhimet që janë në kundërshtim me ideologjitë demokratike dhe sistemet shoqërore.

- ▶ Librat kujdesen për identitetin kombëtar maqedonas.
- ▶ Librat e afirmojnë njohjen, rëndësinë dhe hapjen ndaj vlerave të bashkësive etnike, nacionaliteteve dhe kulturave tjera në Evropë dhe në botë dhe zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë ndaj Republikës së Maqedonisë si bashkësi e qytetarëve të barabartë, pavarësisht përkatësin e tyre etnike dhe fetare.
- ▶ Librat e pasqyrojnë pluralitetin e shoqërisë maqedonase( kulturor, ekonomik, të moshës, gjinor dhe dallimet tjera)
- ▶ Librat objektivisht dhe me besueshmëri i paraqesin grupet etnike dhe religjioze.
- ▶ Librat e pengojnë diskriminimin, mosdurimin dhe paraqitjen negative të individit dhe grupeve shoqërore duke pasur parasysh gjininë, moshën, orientimin seksual, racën, përkatësin etnike dhe religjioze, mënyrën e jetesës, përcaktimin politik, origjinën ekonomiko-sociale dhe të gjitha llojet dhe shkallën e pengesave të personave me nevoja të posaçme.



# **III. STANDARDET TEKNIKE TË LIBRIT**





Libri ka format A4 ose B4 dhe prej tyre formate të nxjerra, të zgjeruar etj.

Madhësia e shkronjave në libër varet prej moshës së nxënësit të cilit i dedikohet.

Mund të përdoren këto lloje të letrave që kanë shenja të qarta grafike dhe i përshtaten letrës në gjuhën me të cilën është shkruar libri, ndërsa distanca në mes shenjave duhet të jetë e mjaftueshme që të mundet fjala e botuar të jetë e lexueshme dhe të duket qartë. Sipas këtyre kriterëve përcaktohet kjo madhësi e shkronjave:

- ▶ Për përmbajtje për librat prej klasës së parë dhe të dytë nuk duhet të përdoren shkronja me fond më të vogël se 14;
- ▶ Për përmbajtjet e librave prej klasës së tretë deri në klasën e nëntë nuk duhet të përdoren shkronja me fond më të vogël se 12;
- ▶ Për përmbajtjet e librave për arsimin e mesëm nuk duhet të përdoren shkronja me fond më të vogël se 11.
- ▶ Sa i përket përgatitjes teknike të librit rekomandohet :
  - Libri të organizohet sipas kapitujve të cilat çdo herë fillojnë me faqet e tyre përcjellëse ku gjendet përmbajtje e shkurtër, tërësi, fjalë kyçe, rezyme të kapitullit.
  - Të gjitha temat në kuadër të kapitujve gjithashtu të fillojnë në faqen e re.
  - Në faqe përveç tekstit si element themelor mund të hasen : tabela, ilustrime, fragmente, etj. pozicionin

i tyre duhet të organizohet në mënyrë vizuale, nuk dëmtohet tërësia e tekstit, sipas mundësisë të pozicionohet kah skajet e jashtme të faqes.

- Për të gjithë titujt do të duhet të përdoret fond i njëjtë si (nga madhësia dhe lloji).
- Ilustrimet janë të paraqitura me tekst me fond me madhësi më të vogël prej tekstit themelor.
- Tabelat gjithashtu me numra dhe me shkrim; nuk shënohen si ilustrime, por përdoren titujt e tabelave.
- Numërimet janë të nënvizuara dhe të veçuara vizualisht nga teksti themelor. Mund të përdoren marker për numërim.
- Vizualisht duhet të veçohen nga teksti themelor fragmente ku nxënësi duhet të ketë kujdes të posaçëm ( mund të veçohen me hije nga teksti themelor).
- Kopertina e librit gjithashtu duhet të përmbushë kriteret adekuate. Meqë kopertina përpunohet në kolor teknikë i shfrytëzon të gjithë përparsitë e asaj teknike. Duhet të përpunohet që ana e përparshme dhe ana e prapme e kopertinës të përbëjnë tërësi vizuale me pjesën e shpinës.

Për botimin e librit përdoret letër që është e prodhuar në përputhje me ISO standardet ( sipas standardevë dhe normave ndërkombëtare).

Librat duhet të botohen në letër mat, sipas rregullës përbërje pa dru/ofset me peshë minimum 75 gram/m.

Botimi i librit duhet të sigurojë shkallë të lartë të leximit dhe qartësi grafike dhe figurative.

Për librat propozohet kopertinë e brushuar e plastifikuar (lidhje të butë), qëndrueshmëri për përdorim më të gjatë të librit.

# BIBLIOGRAFIA

---

- ▶ Andrilovic V., Cudina M. (1985) Psihologija ucenja i nastave, Skolska kniga, Zagreb
- ▶ G.Neuner-H.Hunfeld, Methoden des fremdsprachlichen Deutschunterrichts, 1997, Druckhaus Langescheidt, Berlin;
- ▶ Insights from the Common European Framework, 2004, Oxford University Press
- ▶ Jack.C. Richards, Willy A. Renandya- Methodology in Language Teaching, Cambridge University Press:
- ▶ Концепција за деветгодишно основно воспитание и образование, (2007) Биро за развој на образованието, Скопје
- ▶ Концепција за учебник за основно и за средно образование, (2006), Министерство за образование и наука, Биро за развој на образованието, Скопје
- ▶ Концепција за учебник за основно и за средно образование, (1998) Педагошки завод на Македонија, Скопје
- ▶ *Methodology in Language Teaching edited by Jack C. Richards & Willy A. .... Reflective Teaching in Second Language Classrooms by Jack C. Richards Cambridge University Press (April 8, 2002) ... of 5 stars;*
- ▶ Methodes et pratiques des manuels de langues, Henri Besse, 1985,Didier
- ▶ L'elaboration des manuels scolaires. Guide methodologique, Roger Seguin, 1989,UNESCO
- ▶ Myers G.D., (1989) Second Edition, Worth Publishers, Inc., New York
- ▶ Методологија за вреднување на учебниците за основно и за средно образование, (2005) Биро за развој на образованието, Скопје
- ▶ Паладин, А., Михајловиќ-Бокан, Д. (2009): *Уџбеници музичке културе*, Нови Логос, Београд
- ▶ Петреска, В и др. (2009) Студија за мултикултурализам и меѓуетнички односи во образованието, Канцеларија на УНИЦЕФ, Скопје
- ▶ Пешиќ, Ј. (1998) Нови приступ структури уџбеника: Теоријски принципи и конструкцијска решења, Београд, Завод за уџбенике и наставна средства
- ▶ Плут, Д. (2003) Уџбеник као културно – потпорни систем, Београд, Завод за уџбенике и наставна средства
- ▶ Попоски, К. (1992) Знаењето и неговото усвојување, Просветно дело, Скопје
- ▶ Попоски, К. (1997) Психолошки основи на современата настава, Просветна дело, Скопје
- ▶ Прилози за наставата по историја во основното и средното образование, (1995) Педагошки завод на Македонија, Скопје
- ▶ Растоварување на наставната програма по историја за основното образование, (1995) Педагошки завод на Македонија, Министерство за образование и физичка култура, Скопје

- ▶ Реформски образовни кругови, (2005) Водич за унапређење рада наставника и школа, Београд
- ▶ **SMJERNICE ZA PISANJE I OCJENU UDŽBENIKA GEOGRAFIJE ZA OSNOVNE I SREDNJE ŠKOLE U BOSNI I HERCEGOVINI (2005)**, Komisija za izradu smjernica koncepcije novih udžbenika u Bosni i Hercegovini
- ▶ Смрекар-Станковић, М., Цветковић, С. (2009) *Приручник за учиишеље*, Едука д.о.о., Београд
- ▶ Стојановски, Т. и Тимовски, В. (2009) Методологија за вреднување на учебниците за основно и за средно образование, Министерство за образование и наука, Биро за развој на образованието, Скопје

Користени учебници:

**Биологија и природни науки** - Англија (издавачи: McGraw-Hill Science, Oxford University Press (GSCE), Jones and Bartlett Publishers, Inc., Garland Science Taylor and Francis Group, W.W.Norton & Company)

Германија (издавачи: Westermann, Klett, Schroedel, Cornelsen, Duden Paetec.)

Франција (издавачи: Nathan, Hachette, Belin)

САД (издавачи: Glencoe, Pearson/Prentice Hall, Freeman)

**Хемија**

Франција: Nathan, Hachette, Belin

Англија: Oxford University Press (GSCE), Glencoe, McGraw-Hill Science (chemistry; Science)

Германија: Cornelse/Volk und Wissen, Duden Paetec, GmbH Duden Schulbuchverlag, KLETT, SCHROEDEL

САД: Glencoe, Pearson/Prentice Hall, Freeman

Турција: ZAMBAK (publishing, Istanbul Turkes, chemistry series)



# **METODOLOGJIA PËR VLERSIMIN E LIBRIT**





Vlerësimi i librit duhet të bëhet në bazë të kriterëve që duhet ti përmbajë çdo libër. Në bazë të Ligjit për libra për shkollim fillor dhe të mesëm vlerësimin e bëjnë komisione recensuese në bazë të kompetencave të tyre profesionale, si dhe në bazë të indikatorëve që dalin nga kriteret e përgjithshme për përpunimin e librit.

Gjithashtu, komisionet recensuese, në bazë të mendimit profesional të çdo anëtari, japin notën përfundimtare për çdo dorëshkrim të propozuar për librin dhe propozojnë dorëshkrim që do të jetë i pranueshëm për libër.

Byroja e zhvillimit të arsimit përgatit pyetësor për vlerësimet e librave të zhvilluara në pesë pjesë të veçanta ( në pajtim me kriteret për përpilimin e librave):

- ▶ Pjesa e parë ka të bëjë me vlerësimin e librit në raport me përshtatjen e dorëshkrimit me programin mësimor;
- ▶ Pjesa e dytë është për përqendrimi ndaj të arriturave bashkëkohore të fushës së caktuar shkencore dhe përdorimi i terminologjisë shkencore në libër,
- ▶ Pjesa e tretë është për përputhshmërinë e dorëshkrimit me moshën e nxënësve,
- ▶ Pjesa e katërt është për funksionin edukativ të dorëshkrimit.

Secili anëtar i komisionit recensues i vlerëson dorëshkrimet pavarësisht ( në përputhje me tabelën 1 – tabelën 4 të dhënat në shtojcë) dhe jep notë për secilin indikator të theksuar të shkallës prej 1 deri 3, me çka 1 paraqet indikator të paplotësuar, 2 pjesërisht të plotësuar, ndërsa 3 se indikator i është plotësisht i përpiktë në libër.

Dorëshkrimi për librin duhet të plotësoj minimum pikë për secilën tabelë në veçanti. Në bazë të pikëve të posaçme, komisioni zbaton vlerën mesatare nga të tre pikët në veçanti, me çka për indikatorët e tabelës së parë nuk guxon të jetë më e vogël se 10 pikë, për indikatorët e tabelës së dytë nuk guxon të jetë më e vogël se 20 pikë, për indikatorët e tabelës së tretë nuk guxon të jetë më e vogël se 16 pikë, ndërsa për indikatorët e tabelës së katërt nuk guxon të jetë më e vogël se 18 pikë.

Nëse një dorëshkrim ka më pakë pikë prej minimumit të caktuar në cilën do qoftë tabelë ose në kuadër të cilës edhe të jetë tabelë, katër anëtarët e komisionit recensues indikator të posaçëm e kanë vlerësuar me 1, ai dorëshkrim nuk hyn në procedurën e mëtejshme të pikëve dhe radhitjes së librit.

Pikët e fituara futen në tabelën 6 në radhët, në pajtim me indikatorët, të shënuara prej I deri në IV.

Në tabelën 5 komisioni recensues (bashkërisht) duhet të jep mendim përmbledhës (narrativ) mendim profesional për dorëshkrimin (prej 250 – 300 fjalë) dhe të jep notën e vetë prej 1 – 5.

Nëse ndonjë prej anëtarëve të komisionit recensues ka shprehur mendimin, e njëjta shkruhet në pjesën narrative.

Pikët e tabelës 5 shtohen në radhën e V të tabelës 6 dhe nxirret notë përfundimtare e shprehur në numra, me çka nënshkruhen të gjithë anëtarët e komisionit recensues.

*Pyetësor për vlerësimin e librit për arsimin fillor ose të mesëm*

**Përputhshmëria e përmbajtjes së librit me programin mësimor**

Numri rendor	Indikatorë për vlerësimin e librit	Pikët		
		1	2	3
I.	<b>Përputhshmëria e përmbajtjes së librit me programin mësimor</b>			
1.	Libri i përmban të gjitha temat/fushat e parapara me programin mësimor			
2.	Në libër janë të zhvilluara përmbajtje në pajtim me qëllimet e përgjithshme dhe konkrete të programit mësimor			
3.	Numri i përmbajtjeve të parapara është racionale dhe ekonomike.			
4.	Në përmbajtje janë përfshirë (përpunuar) të gjitha termet e parapara me programin mësimor			
5.	Libri i ndjek metodat, aktivitetet dhe drejtimet didaktike për realizimin e programit mësimor			
	<b>Gjithsej</b>			

**(tabela 1)**

**Përqendrimi ndaj të arriturave bashkëkohore në fushën e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës dhe përdorimi i terminologjisë shkencore**

Numri rendor	Indikatorë për vlerësimin e librit	Pikët		
II.	<b>Përqendrimi ndaj të arriturave bashkëkohore në fushën e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës dhe përdorimi i terminologjisë shkencore</b>	1	2	3
1.	Përmbajtjet në libër bazohen në fakte shkencore			
2.	Në libër në mënyrë korrekte përdoret terminologjia shkencore e lëmit/fushës së caktuar.			
3.	Libri ka strukturë të qartë dhe të kuptueshme.			
4.	Libri i përmban elementet themelore gjatë zhvillimit të përmbajtjeve (teksti themelor, sqarimi i termeve, pyetje dhe detyra, ilustrime, tekste plotësuese, kahe etj)			
5.	Me përmbajtjet dhe detyrat për nxënësit mundësohet zhvillim të aftësive të tyre nga fushat kognitive- të kuptuarit, aplikimi i njohurive, analiza, sinteza, vlerësimi			
6.	Në libër ofrohet përpunim i sistematizuar dhe miratimin e termeve ( në thjeshtësimin drejt të ndërlikuarës, drejt thellimit dhe zgjerimit të njohurive).			
7.	Pyetjet dhe detyrat në libër janë të koncipuara ashtu që i japin bazë nxënësit t'i zbulojë dhe t'i lidhë njohurit.			
8.	Në libër ka detyra për përsëritje dhe verifikim të njohurive.			
9.	Përmbajtjet, pyetjet, detyrat dhe shtojcat tjera i stimulojnë nxënësit për aplikimin e njohurisë.			
10.	Shtojcat vizuale janë në funksion të përmbajtjeve			
	<b>Gjithsej</b>			

(tabela 2)

### Përputhja e librit me moshën e nxënësit

Numri rendor	Indikatorë për vlerësimin e librit	Pikët		
III.	<b>Përputhja e librit me moshën e nxënësit</b>	1	2	3
1.	Libri është në përputhje me karakteristikat zhvillimore të nxënësve ( intelektuale, emocionale, sociale dhe karakteristika tjera të nxënësve karakteristike për moshën të cilën e mësojnë lëndën mësimore).			
2.	Në libër përdoret gjuhë letrare standarde.			
3.	Gjuha dhe stili në libër janë të kuptueshëm për moshën e nxënësve për të cilët është dedikuar			
4.	Në libër ka sqarime për fjalët e panjohura ose fjalër kuptimi i së cilave nxënësit nuk e dinë (fjalë/terme që për herë të parë përdoren)			
5.	Në libër i kushtohet vëmendje pasurimit të fjalorit ekzistues të nxënësve për lëndën mësimore			
6.	Në mënyrë adekuate përdoren shkurtesat, simbolet dhe shenjat e normuara në standardet e gjuhës në të cilën është shkruar libri ( gjuhë maqedonase, gjuhë shqipe, gjuhë turke, gjuhë serbe ose gjuhë tjetër) si dhe njësit e parapara matëse dhe shkurtesat e tyre.			
7.	Në përmbajtjet ka renditje logjike të gjendjeve, aksioneve, ngjarjeve.			
8.	Shtojcat vizuale janë në përputhje me moshën e nxënësve për lëndën e dhënë dhe qartë dhe sistematikisht i paraqesin të dhënat, dukurit konkrete, termet etj			
	<b>Gjithsej</b>			

(tabela 3)

*Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/njohurive, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, multikulturën dhe barazinë gjinore*

Numri rendor	Indikatorë për vlerësimin e librit	Pikët		
IV.	<i>Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/njohurisë, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, multikulturën dhe barazinë gjinore</i>	1	2	3
1.	Libri i ndjek dhe i promovon parimet dhe qëllimet e edukimit dhe arsimimit të përcaktuara me qëllimet e arsimimit dhe edukimit në Republikën e Maqedonisë (koncepte, ligje), deklarata për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve dhe deklarata tjera ndërkombëtare dhe akte për përparimin e procesit edukativo-arsimor.			
2.	Përmes përmbajtjeve në libër mundësohet zhvillim i aftësive për pranimin e vlerave dhe formimin e qëndrimit.			
3.	Në libër janë përfshirë përmbajtje për zhvillimin personal dhe social të nxënësve (komunikimi, shëndeti, zgjedhje paqësore e situatave konfliktuoze, mbrojtjen e mjedisit hapësinor etj.)			
4.	Në libër nxitet raporti pozitiv ndaj njohurisë.			
5.	Në libër ofrohen përmbajtje dhe qasje të cilat e zhvillojnë identitetin kombëtar dhe qytetar të përfaqësuesit e të gjitha bashkësive etnike/kulturore në vend.			
6.	Në libër janë përfaqësuar pjesëtarët e bashkësive etnike/kulturore të ndryshme që jetojnë në Republikën e Maqedonisë (gjithkund ku mundet, varësisht nga lëmi/fusha e librit)			
7.	Në libër u shmanget (në mënyrë eksplicite ose implicite) prodhimit të stereotipave gjinore			
8.	Përmes teksteve, shtojcave vizuale, gjuhës etj, libri kontribuon në sensibilizimin e barazinë gjinore, si dhe të drejtave dhe lirive të njeriut			
9.	Libri promovon parime etike (në pajtim me parimet adekuate të disiplinës shkencore)			
	<b>Gjithsej</b>			

(tabela 4)

## Mendimi përfundimtar i komisionit recensues

Numri rendor		Pikët
V.	Mendimi përfundimtar i komisionit recensues	Deri 5 pikë

Numri rendor		Pikët
V.	Mendimi përfundimtar i komisionit recensues	Deri 5 pikë
	Gjithsejt	

(tabela 5)



Numri rendor	Pasqyra përmbledhëse e indikatorëve	Pikët
I.	Përputhshmëria e përmbajtjeve të librit me programin mësimor	
II.	Përqendrimi ndaj të arriturave bashkëkohore në fushën e caktuar shkencore, metodologjia e të mësuarit të lëndës dhe përdorimi i terminologjisë shkencore	
III.	Përputhshmëria e librit me moshën e nxënësve	
IV.	<i>Libri ka funksion edukativ, e nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/njohurisë, zhvillimin e identitetit kombëtar dhe qytetar, multikulturën dhe barazinë gjinore</i>	
V.	Mendimi përfundimtar i komisionit recensues	
	Gjithsej	

(tabela 6)

Nënshkrimi i anëtarëve të komisionit recensues:

\_\_\_\_\_ kryetar  
 \_\_\_\_\_ anëtar  
 \_\_\_\_\_ anëtar





Ministria e Arsimit dhe Shkencës



---

Byroja e zhvillimit të arsimit